

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7738 E premte 14 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**  
Arsimi ynë i lartë publik sot është i sëmurë rëndë. Në kllapi të plotë gjobëvënieje. Ka infektuar me duhmën e tij të rëndë brezin më premtues të shoqërisë ...  
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI  
**Si kurohet universiteti gjobëvënës?**  


**Opinion** *i* **Ditës**  
Historia e viteve të fundit na ka dhënë një mësim: qeveritë fillojnë e shkërmoqen, kur i del boja propagandës. Fatos Nano nuk rikuperoi më kurrë ...  
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI  
**Qeveria po bie, i ka vdekur propaganda**  




Qeveria tërhiqet për procedimet penale  
**Studentët, protestë para Kuvendit. Rama bën 'për ujë të ftohtë' dekanët: Faji juaj**

Të rinjtë e gdhijnë tek kryeministria: Nuk negociojmë, të zbatohen 8 pikat e kërkesës

Me mijëra protestues nga universitetet e Tiranës, por edhe të ardhur nga rrethet kanë protestuar dhe për të nëntën ditë me radhë për tarifa më të ulëta studimi dhe kushte më të mira mësimi. Që në orët e para të mëngjesit të djeshëm ata u mblodhën para Rektoratit dhe me libra e Kushtetutë në duar, nisën marshimin nga sheshi "Nënë Tereza" ...  
Në faqet 2-3

## KOMPENSIMI/ QEVERIA MIRATON FONDIN, PUBLIKOHET LISTA E PERFITUESVE EMRAT E PRONAREVE QE NDAJNE 6 MILIONE EURO

Lista e familjeve që marrin paratë në Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan dhe në bregdet. Të dhënat e detajuara për sipërfaqet dhe çmimin për metër katror



(Në foto) Toka të zëna nga ndërtime pa leje

**AKUZA PER PERNDJEKJE**  
**Rasti "Xhisiela",** prokuroria kërkon një vit burg për djalin e deputetit  
Në faqen 6

**"E KERKOI BALLA I PS"**  
**Kërkesat e studentëve, Meta kthen buxhetin e 2019 në Kuvend**  
Në faqen 4

**PROTESTA E BANOREVE**  
**Skandalit me tenderin te Unaza, banorët: Përgjegjësit të shkojnë në burg**  
Në faqen 5

**ATHINE**  
**Vritet një tjetër shqiptar në Greqi, policia: U qëllua me plumb në kokë**  
Në faqen 6

### MBESHETJA NGA SHBA



**Kosova krijon sot ushtrinë, "Deutsche Welle":** Taçi-Vuçiqç duan shkëmbim tokash  
Në faqen 11

Ministria e Financae publikon emrat, 3 muaj afat për të dorëzuar dokumentet

## 2800 të përndjekurit që marrin dëmshpërblimin

Lista e re: Trashëgimtarët që përfitojnë këstin e tretë të parave

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që nuk kanë marrë dëmshpërblimi e kështu të tretë duhet të dorëzojnë sa më parë në Ministrinë e Financae dokumentet që iu mungojnë në dosje për të mos humbur të drejtën për të marrë paratë. Burime zyrtare nga Ministria



e Financae bëjnë të ditur se janë mbi 2771 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të cilët duhet të plotësojnë dosjet për të filluar pagesat e kështu të tretë. Sipas të njëjtave burime mësohet se trashëgimtarët njihen si përfitues, por ...  
Në faqet 8-9

**PROTESTA**  
**NGËRÇI**

Kryeministri pranoi dje se protesta e studentëve i dha një shuplakë qeverisë

# Rama: Plotësojmë 8 pikat, te Kryeministria protestojnë militantët

## "Një aleancë politiko-ekonomike do rrëzimin e qeverisë"

Kryeministri Edi Rama ka konfirmuar edhe një herë dje në mbledhjen e 8 kërkesat e paraqitura nga studentët, por që kjo të bëhet e mundur ai theksoi se është e domosdoshme që të ulet në bisedime. Duke folur përpara një paneli gazetarësh në emisionin "Opinion" në Tv Klan, ai bëri të qartë se kërkesat që shprehen nga studentët protestues janë të drejta dhe të plotësueshme, por rrethkoshi se ai nuk do të hedh asnjë hap në drejtim të plotësimit të tyre nëse studentët nuk pranojnë të ulen në tryezën e dialogut. "Ndërsa në rastin kur dilet me disa kërkesa se çfarë duhet të bësh atëherë patjetër që duhet të dialogosh. Unë e kam thënë po, jam dakord me të 8 pikat. Nëse qeveria merr vendim pa i konsultuar paraprakisht është e sigurt që do thoheshin se nuk është ky vendimi që kishim ndërmend, ky vendim nuk është ajo që ne donim", tha kryeministri. Ndërkohë që ai nuk nguroi t'i cilësojë si militantë partiakë të gjithë ata që qëndrojnë para kryeministrisë duke ndezur zjarre. Madje ai tha se ata janë të sponsorizuar nga parti të politike. "Ata që po rinë para kryeministrisë mund të qëndrojnë të zjarri para kryeministrisë 10 vjet. Ata janë aty të financiar me ushqime, me zjarre e batanije. Unë flas për ata që janë aty. Unë flas për mijëra të tjerë që kanë ngritur kërkesa dhe kanë të drejtë", theksoi Rama. Duke u ndaluar në kërkesat konkrete të studentëve, ai u shpreh se ishte gati ta përgjysmojë tarifën e studimit por sipas një shkallëzimi. "Ne jemi gati të vijmë me përgjysmim për të gjithë, por me shkallë. Ata që janë ekselehtë të mos kenë tarifë. Ata që janë me ndihmë ekonomike të mos paguajnë. Madje këtyre dy kategorive ti japim dhe bursa. Edhe atyre të tjerëve jemi gati t'u a përgjysmojmë, por me një afat. Nëse ata nuk arrijnë të marrin nota të mira, atëherë ata nuk do përfitojnë më", bëri të ditur Rama.



Studentët duke protestuar para godinës së kryeministrisë

### Kryeministri ngr tonet me rektorët: Mos u fshihni, faji edhe i juaji

Kreu i qeverisë ia ka kufaturuar drejtuesve të universiteteve situatën në të cilën ndodhet sot vendi, ku prej 9 ditësh me radhë studentët kanë bojkotuar auditorët e mësimin. Ai ka zhvilluar dje në mbledhjen e rektorëve një takim me të gjithë rektorët dhe drejtuesit e fakulteteve, ku me tone të larta dhe duke goditur tavolinën, ka deklaruar se të gjithë drejtuesit e universiteteve janë fajtorë për situatën e krijuar për gjendjen e studentëve që solli protestën. "Por mirë mo ç'jeniu ju, kryetarë komunarsh? Kryetarët e komunave që ne zhbllojmë apo kryetarët bashki nëpër provincë që shfrytëzojnë buxhetet për të punësuar njerëz kot. Këtë si ma shpjegoni?", tha Rama. Ai theksoi se është skandaloz që teksa punësohen njerëz pa fund universitetit i marrin sot kuotë arsimimi të verbërve apo per-



sonave të tjerë me aftësi të kufizuara. "1000 e ca rroga, ndër kohë që dalin të verbër, studentët e verbër që nuk kanë as lehtësinë më të vogël dhe nuk është ngritur njëherë ky problem", deklaroi kryeministri. Rama u shpreh se protesta e ka ndryshuar edhe atë vetë personalisht në raport me universitetin, ndërsa u kërkoi rektorëve që të mos fshihen më, por të marrin përsipër përgjegjësitë që kanë. "Kjo nuk do vazhdojë më kështu. Çfarë ju kërkohet është, mos

u fshihni më", tha Rama. Ai theksoi se tarifën e studimit janë përgjegjësi të universitetëve për t'propozuar dhe e qeverisë për t'i miratuar". Rama u shpreh se kjo protestë dhe këto problematika nxorën në pah se autonomia e universiteteve në këtë masë ishte e nxitur, ndërsa tha se duhet rishikuar. Ai nuk nguroi të sulmtojë rektorin e Universitetit të Tiranës se nuk ka kuptuar ligjin dhe se shumicën e fondeve që i jep qeveria i ka çuar për të blerë makina e bazë materiale. "Nuk aludoj, por konstatoj që rektori i Universitetit të Tiranës nuk ka kuptuar ligjin për arsimin e lartë, që është aty për vendimmarje. Zëri kryesor në buxhet është automjete dhe orëditë për zyra, kam parë specifiku nga një universitet ku dekani kërkoi veturë 76 mijë euro", u shpreh Rama.

dha një grusht opozitës; e treta, protesta i dha një shprehje shoqërisë. Nga ky dialog duhet të dalë një marrëveshje e kalendariuuar, ku për çdo pikë të merren përgjegjësi dhe përgjegjësit e ngarkuar nga marrëveshja, të përgjigjen për zbatimin, ose moszbatimin e çdo pikë", tha Rama. Gjithsesi ai theksoi se shumica e pikave që kanë

parashtruar studentët për zgjidhjen nuk kanë lidhje me qeverinë. "Trecerëku i atyre pikave janë çështje të brendshme të universitetit", shtoi Rama. Ai hodhi dyshime se një grup i caktuar politik, ekonomik dhe akademik kërkoi të shfrytëzonte protestën për rrëzimin e qeverisë. "E gjithë ajo zonë e jetës shoqërore, e jetës poli-

tike, e jetës akademike, e jetës ekonomike të vendit, që do rrëzimin e kësaj qeverie, që nuk ka lidhje fare me studentët që duan të trajtojnë çështjen e diskriminimit të tyre brenda mureve të universitetit. Kjo është arsyeja, pse unë jam këtu, bashkë me ju, në krahun e studentëve. Unë nuk dua që kjo protestë të mbarojë", tha Rama.

**RUDINA HAJDARI**  
Pjesë e seancës së djeshme plenare u bë edhe deputetja demokrate, vajza e ish-liderit të dhjetorit 91, Azem Hajdari, Rudina Hajdari. Por ndryshe nga kolegët e saj opozitarë, përfaqësia e deputetëve të PD dhe LSI, të cilët shkuan dje në seancë për të mbrojtur amendimet ligjore për buxhetin e shtetit 2019, Hajdari shkoi pa u koordinuar me partinë e vet.

**SHKURTE**

**Ministria Nikolla: Jam e gatshme të marr çdo përgjegjësi**

Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla është e shprehur me gatshmëri të marrë çdo përgjegjësi në lidhje me situatën në të cilën ndodhet sot arsimi i lartë, duke lënë të kuptohet se ishte e gatshme për të dhënë edhe dorëheqjen. Nga foltojtari e Kuvendit, teksa reflektoi edhe emocion gjatë fjalës së saj, Nikolla tha se kërkesat e studentëve ishin të drejta. "E vërteta dhe puna ka qenë aleati më i mirë, për t'ju kundërvënë një turravrap. Ata kanë të drejtë dhe unë jam e gatshme për të marrë çdo përgjegjësi" - u shpreh Nikolla. Ajo theksoi se pavarësisht problemeve, puna e bërë në këto 5 vite në arsimin e lartë ka qenë kolosale dhe se ligji për arsimin e lartë do të dhënë rezultate. Ajo u përgjigj edhe thirrjeve të studentëve, ndërsa bëri të ditur se nuk kishte pasur problem që të dilte dhe të diskutonte me ta në shesh. "Në 5 vite mbyllëm 22 universitete, miliona euro të shkuara dëm nga xhapat e shqiptarëve, por koha do të flasë. Reformuam universitetet, akredituam universitetet, por koha do të flasë. Studentët kanë të drejtë. A janë sot të nevojshme ndryshimet se si përgatiten studentët? Për këtë s'ka nevojë të flasë koha, por e bërtas edhe unë. Ligji duhet zbatuar dhe kërkohet kohë. Por me studentët gjithkush ka të drejtë të drejtojë gishtin. "Lindita dil nga ministria të kanë ardhur studentët dhe jo ushtria", thanë studentët, dhe unë dola, dhe nuk e kam problem, për të mos turpëruar askënd" - tha Nikolla.

**Mazhoranca rrëzoi propozimet e opozitës për amendimet e buxhetit**

Kuvendi ka rrëzuar dje me votat e mazhorancës përfaqësuesit të Levizjes Socialiste për Integritet për të amenduar Buxhetin e Shtetit të vitit 2019 dhe për t'i dhënë zgjidhje kërkesave të studentëve. Diskutimi i këtyre amendamenteve solli në parlament edhe opozitën, ku një përfaqësues prej afro 8 deputetësh nga LSI dhe PD kërkuan me forcë që Kuvendi t'i fusë këto ndryshime në rendin e ditës. Nuk munguan as tensionet në sallë, mes kryeministrit dhe deputetëve të opozitës, të cilët bënë atë përgjegjës për situatën në të cilën ndodhet sot vendi dhe në mënyrë të veçantë arsimi i lartë në vendin tonë. Ndërkohë që përfaqësuesit e shumicës qeverisëse sollën si argument për rrëzimin e kësaj kërkesë pikërisht faktin se Buxheti i Shtetit për vitin e ardhshëm nuk ishte dekretohet ende nga Presidenti i Republikës dhe për rrjedhojë nuk mund të amendohet. Gjithashtu, shumica qeverisëse theksoi se Buxheti 2019 hynë në fuqi në datë 1 janar dhe për këtë arsye s'është në gjendje të amendohet. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi sqaroi se edhe nga ana procedurale propozimet nuk mund të hyjnë për diskutim në seancë pa kaluar dy javë nga data e paraqitjes së tyre.



Protestuesit kanë qëndruar dje para Kuvendit dhe kanë refuzuar dialogun

# Dita e 9 e protestës, studentët të vendosur: Të plotësohen 8 pikat

## Studentët do zgjedhin një përfaqësi drejtuese

**M**e mijëra protestues nga universitetet e Tiranës, por edhe të ardhur nga rrethet kanë protestuar dje për të nëntën ditë me radhë për tarifa më të ulëta studimi dhe kushte më të mira mësimi. Që në orët e para të mëngjesit të djeshëm ata u mbledhën para Rektoratit dhe me libra e Kushtetutë në duar, nisën marshimin nga sheshi 'Nënë Tereza' për t'u stacionuar në hyrjen që të çon në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë në rrugën "Xhorxh Bush", ndërsa hodhën parulla dhe thirrje kundër situatës në të cilën ndodhet sot arsimi i lartë. Ata i kërkuar kryeministrit Edi Rama dhe mazhorancës që ai drejton që të plotësojë 8 kërkesat e tyre, ndërsa refuzuan në mënyrë kategorike çdo thirrje të tij për dialog. Ndryshe nga ditët e tjera, dje studentët ishin më të organizuar teksa kishin marrë masat për të vendosur edhe një foni për të përcjellë mesazhet e tyre, ndonëse ajo përdori për shkak se zona përreth nuk kishte energji.



**ORGANIZIMI**  
Ndryshe nga ditët e tjera, dje studentët ishin më të organizuar teksa kishin marrë masat për të vendosur edhe një foni për të përcjellë mesazhet e tyre, ndonëse ajo përdori për shkak se zona përreth nuk kishte energji.

### Lleshaj ndryshe nga policia: Nuk është procedurë askush për protestën

Protesta e studentëve ka futur në një përplasje institucionale edhe ministrin e Brendshëm me Policinë e Shtetit. Kështu kreu i ri uniformave blu, Sandër Lleshaj mohoi dje nga sallat e parlamentit që policia të kishte procedurë ndonjë protestues apo figura të njohura publike, siç ishte edhe rasti i pedagogut Edmond Tupja, për pjesëmarrjen në protestë, duke i konsideruar të pavërteta lajmet e përhapura në media për këtë gjë. "I kam kërkuar Policisë së Shtetit informacione të detajuara rreth kësaj ndërhyrjeje, rreth këtij procedimi dhe për befasinë time të madhe rezultoni që lajmi është plotësisht i pavërtetë. Dje nuk ka pasur kurrfarë procedimi penal ndaj asnjë pedagogu dhe ndaj asnjë studenti pjesëmarrës në protestat e vendit", tha Lleshaj. Por dy ditë më parë, ishte vetë Policia e Shtetit ajo që nëpërmjet një deklarate për mediat, bënte të ditur faktin e procedimit të 25 studentëve dhe disa figurave publike, mes të cilëve edhe Edmond Tupja dhe Robert Aliaj. "Në zbatim të procedurave standarde policore dhe të detyrimeve ligjore, Policia e Shtetit ka filluar procedime në bazë të ligjit për raste të shkeljesura personash, të cilët e kanë cenuar qartazi atë, kryesisht në formën e bllokimit të akteve rrugore të vendit, goditjes me sende të forta, apo djegies së materialeve të dëmshme për shëndetin e qytetarëve në mjedis të rëndësishme publike", bënte të ditur Policia e Shtetit. Por ministri paralajmëroi nisjen e procedurave për të zbuluar përgjegjësit në Policinë e Shtetit për këtë lajm të pavërtetë.



### Studentët sfidojnë të ftohtin e natës, qëndrojnë para Kryeministrit

Studentët kanë vijuar protestën e tyre, duke qëndruar para kryeministrit ashtu si edhe dy netët e mëparshme. Ata studentët po kalojnë natën jashtë, të mbështjellë me batanije që ua sjellin qytetarët e Tiranës, bashkë me ushqime, në shenjë solidariteti me protestën e tyre. Një nga studentët teksa qëndron para godinës së kryeministrit falënderoi të gjithë qytetarët që mbremjen e djeshme sollën dru zjarr për ta, por shtoi se policia nuk i lejoi të ndiznin zjarr edhe pse temperaturat ishin të ulëta. Në fjalën e tyre ata iu bënë thirrje qytetarëve të sjellin batanije dhe çadra për studentët, pasi ashtu siç ka ndodhur edhe netët e tjera, një pjesë e tyre do të qëndronin para kryeministrit. Por ashtu si edhe një natë më parë policia nuk i la lejuar ata të ndezin zjarr çka ka shkaktuar një tension te studentët pasi efektivitet kanë tentuar të bllokojnë disa fuçi, të cilat u sollën me lëndë drusore për t'u ngrohur. Pavarësisht tentativës për t'i bllokuar, studentët arritën t'i sillni ato pranë grupit ku ishin dhe protestuesit e tjerë. Ndërkohë që pas përplasjes me studentët, burime nga Policia e Shtetit i thanë "Balkan-Web" se Kryeministria është objekt i rëndësishëm së veçantë dhe nuk lejohet ndezja e zjarreve përreth godinës. Ndërkohë jo vetëm për këtë, por sipas tyre djegia e druve shkaktonte edhe ndotjen e mjedisit.



Studentët e arkitekturës i shkruajnë ambasadës së SHBA: Na përkrani

Gjatë ditës së djeshme, nisur edhe nga situata ku kërkesat e tyre nuk po marrin zgjidhje, një grup studentësh të fakultetit të Arkitekturës i kanë shkruar ambasadës amerikane në Tiranë ku i kërkojnë që t'i përkrasin në protestën e tyre. "Ju kërkojmë ndihmë dhe asistencë kështu që protesta jonë do të arrijë objektivitetin. Ju lutem, konsideroni kauzën tonë si tuajën"-thuhet në letrën që studentët i kanë dërguar sot ambasadës amerikane. Letra mbante firmën e 54 studentëve të Arkitekturës.



**SHPLLJE ANKANDI**

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se më datë 20.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-rë për shpiltjen e 4 pasurive të paluajtshme , në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera fillatare në ankand: a) 252,668 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/166, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 b) 244,532 (Dyqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/167, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 c) 316,400 (Treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/172, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 d) 135,600 (Njëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/173, Vol.19, Fq.147, ZK.2704.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Pas afro 4 orë para Kuvendit, studentët me mbarimin e seancës plenare kanë zhvendosur protestën e tyre sërish para kryeministrit, teksa kanë qëndruar gjatë gjithë pasditës dhe orëve të natës. Ndërkohë që për të shmangur përçarjet e mundshme, si ato që ndodhën të martën në mbremje duket se studentët po mendojnë realisht që zgjedhin një përfaqësi të tyre. Një prej studentëve, i cili protestonte përpara Kryeministrit deklaroi dje se po përgatiten për të ngritur përfaqësi në mënyrë që protesta të ketë një organizim. Ai tha se këto përfaqësi nuk do të ngrihen për të dialoguar. "Fakultetet kanë mbledhur studentët për të ngritur një përfaqësi, jo për dialog. Me informacionet që kam unë do ngrihen

perfaqësi për të drejtuar protestën dhe jo për të dialoguar me kryeministrin. Këto janë pika që nuk kanë nevojë për dialog", u shpreh studenti. Ai u shpreh i vendosur se nëse nuk plotësohen kërkesat e tyre do të vazhdojnë protestën. "Edhe nëse nëse nuk ka plotësim kërkesash do të mblihdemi për të kërkuar të drejtat tona", tha studentin.

# UNAZA E RE PROTESTA

Blllokohen rrugët në disa qytete, banorët e Bregut: Jemi qytetarë, jo shpellarë

## Dëmshpërblim dhe anulim të projektit Unaza e re, protestuesit

"Nxirrni nga burgu Danielin, çoni Damianin e Afrimin"

Valentina Madani

Shqipëria u përfshi sërish dje nga protestat në disa prej qyteteve kryesore. Protesta pati në Durrës, Shkodër, Berat, etj. ndërkohë që kanë shprehur mbështetjen për protestën e studentëve si dhe kundër rritjes së çmimit të naftës. Banorët bllokuan edhe autostradën Tiranë - Durrës në të dyja krahët pranë mbikalimit të Shkozetit. Ata protestuan për taksat e larta dhe për papunësinë. Këta banorë mbështetën edhe nga opozita. Edhe në Shkodër për të 4 ditën kanë vazhduar protestat. Me thirrje kundër qeverisë, protestuesit kanë bllokuar rrugën në hyrje të qytetit. Madje mes makinave të bllokua është edhe një makinë policie. Banorët e Shkodrës kundërshtojnë rritjen e çmimit të karburantit, taksat, por edhe varfërinë. Edhe protesta në Shkodër mbështetet nga opozita. Gjatë protestës së zhvilluar në autostradën Tiranë-Durrës, u bllokuan të dyja akset e autostradës për rreth 30 minuta dhe duke paralizuar trafikun në këtë arterie të rëndësishme të qarkullimit rrugor dhe aktivitetit ekonomik. Prej katër ditësh të mbështetur nga Partia Demokratike, banorët e këtyre qyteteve janë ngritur në protestë kundër çmimit të lartë të karburanteve, mungesës së tregut dhe në mbështetje të studentëve në Tiranë.

### UNAZA E RE


Banorët e Unazës së Re protestuan sërish dje kundër projektit të Unazës së Madhe. Prej rreth 2 muajsh banorët mblidhen çdo darkë për të ngritur zërin kundër këtij projekti dhe për të deklaruar se nuk do të lejojnë prishjen e banesave të tyre. Tashmë banorët nuk kërkojnë më dëmshpërblim, por anulim të projektit pas skandalit me firmën që kishin fituar tenderin. "Kjo protestë çoi në zbulimin e një skandalit. Anulo projektin. Këtu vendosim ne", deklaruan banorët. Gjithashtu, pro-



Protesta e banorëve të 'Astirit'

### SHEMBJA

Një tjetër godinë trekatëshe u prish dje në gjurmën e unazës së madhe pranë zonës që njihet si 'Astiri'. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Bashkisë së Tiranës shembi dje një tjetër godinë 3-katëshe të ndërtuar pa leje në gjurmën e Unazës së Madhe tek 'Astiri', duke i hapur rrugë projektit.



Shembja e banesave të Unaza e Re

## ARRSH rihap tenderin për Lotin e parë të Unazës së Madhe

ARRSH rihapi dje procedurat për tenderin e Lotit të parë të Unazës së Madhe në Tiranë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njoftoi sot se pas zgjidhjes së kontratës me bashkimin e operatorëve DH Albania & Biba X, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka rishpallur sot procedurat e garës "Për rehabilitimin e segmentit rrugor nga mbikalimi tek Pallati me Shigjeta deri tek rrethrotullimi Shqiponja". Sipas kontratës së ARRSH-së, afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje në këtë tender për-



fundon në datën 14 janar. Ndërsa fondi limit është mbi 2 miliardë e 240 milionë lekë. ARRSH zgjidhi në mënyrë të njëanshme kontratën me fituesin e mëparshëm të tenderit për këtë segment të Unazës së Madhe, "DH Albania

& Biba X". Kompania "DH Albania" rezultoi një kompani fantazmë, që u paraqiti për të marrë pjesë në tenderin me një fond 18.8 milionë euro me dokumentacion të falsifikuar në SHBA.


vjedhje të tillë. Jemi të vendosur dhe do të sulmojmë çdo fadromë, çdo punonjës të ARRSH-së e Bashkisë. Do i sulmojmë tani, sepse mbrojtjen shtëpitë tona, nuk duam më dëmshpërblime, por pezullimin e këtij projekti korruptiv", deklaruan banorët me thirrjet "Poshtë projekti".

### BREGU I LUMIT...

PD ishte edhe dje në mbështetje të banorëve të Bregut të Lumit që kanë protestuar për mungesën e dëmshpërblimeve nga ndërtimi i Bulevardit të Ri. De-

## Skandali me tenderët e "DH Albania", Balla: Të vendosim filtër kontrolli

Duhet të vendoset një filtër që të kontrollojë rreptësisht kompanitë dhe procedurat që ndjekin për të marrë një tjetër. Këtë sugjerim bëri dje kreu i grupit parlamentar socialist në emër të ligjvënësve. Ai kërkojë që prokuroria t'i shkojë deri në fund hetimit. I thanë: po, deputetët e mazhorancës ndryshimeve në ligjin për prokurimin publik, por nuk mjafton për të shmangur depërtimet, siç i quajti Taulant Balla kompanitë fantazmë që marrin paratë e taksapaguesve shqiptarë. "Ne si ligjvënës na takon që të heqim sa më shumë filtrin për të garantuar ofertuesin më të mirë, por edhe cilësinë më të mirë të punëve publike", tha z.Balla. Ai nuk u ndal gjatë në dy tenderët që i dhanë nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve 30 milionë euro kompanisë 'DH Albania'. Por sqaroi se praktikat korruptive kanë vete që grabisin taksat e shqiptarëve. "Mbjaj mend rreth 15-20 vite më parë një kompani turke 'Behase' e la Peqinin e Rrogoshinën pa rrugë e më pas një kompani me emër 'Serenissima' mbajti peng për vite me radhe bypasin e Fierit e të Vlorës", tha Balla.



putetja e PD Jorida Tabaku tha se Partia Demokratike do t'i mbështesë qytetarët deri sa të marrin të drejtën e tyre. Ajo tha se unë e di që këta qeveritarë që sot drejtojnë nuk kanë asnjë standard tjetër përveç vjedhjes e korrupsionit, por këta qytetarë do ta gjejnë të drejtën e tyre me mbështetjen e PD. Tabaku deklaroi se: "Këta qytetarë do të marrin dëmshpërblimin e tyre, nuk do të lejojmë që prona e tyre të preket. Nuk do të lejojmë në asnjë mënyrë që të vijnë dhe t'i nxjerrin nga shtëpitë e tyre në mes të natës ashtu siç ka ndodhur me banorët të tjerë dhe ne do i mbështesim për të kërkuar dëmshpërblim të drejtë ashtu siç iu takon. I bëj thirrje edhe njëherë qeverisë, i bëj thirrje dhe njëherë bashkisë të vijë t'i dëgjojnë këta ban-

orë, të vijë të shohë se kërkesat e tyre janë të drejta ashtu si kërkesat e studentëve janë të drejta, ashtu si kërkesat e bizneseve, kërkesat e fermerëve. Çdo shqiptar proteston dhe kjo duhet të ishte kambanë alarmi për qeverinë, por përsëri qeveria, bashkia ndodhen në një realitet tjetër. Nuk e kuptojnë se çfarë po kërkojnë njerëzit". Sipas saj "në qoftë se sot e gjithë Shqipëria është në protestë, në qoftë se çdo projekt investimi që zhvillohet ka mbrapa vjedhjen dhe korrupsionin, atëherë ka një problem më të madh me këtë qeveri. Ne jemi këtu për të treguar që sot ata që na qeverisin, janë thjesht një bandë hajdutësh që po përpigjen të vjedhin çdo gjë, jo vetëm paratë publike, por edhe shtëpitë e këtyre njerëzve. Nuk kemi për ta lejuar".

Rama: Interesante, presidenti kthen buxhetin e Shqipërisë pas kërkesave të LSI

# Kërkesat e studentëve, Meta kthen për rishqyrtim buxhetin 2019

"Reflektim për plotësimin e kërkesave"



Valentina Madani

Presidenti Meta ktheu dje në Kuvend për rishqyrtim ligjin "Për Buxhetin e vitit 2019". Vendimi u mor duke ndjekur me shumë vëmendje situatën politike me të fundit në vend, si dhe duke vlerësuar konsensusin e gjerë publik mbi kërkesat e studentëve, të cilat janë konsideruar nga të gjithë aktorët politikë si të drejta, legjitime dhe të realizueshme. Në një njoftim në publikuar në faqen e Presidentit, Meta shprehet se duke parë situatën politike në vend dhe kërkesat e studentëve ka vendosur të kthejë për rishqyrtim ligjin e buxhetit, me qëllim që të përmbushen objektivat sociale. Meta thekson më tej se është besimplotë se Kuvendi do të reflektojë për një bashkëpunim gjithëpërfshirës, me qëllim plotësimin e kërkesave të studentëve dhe interesit publik. "Presidenti i Republikës S.H.T.Z. Ilir Meta, duke ndjekur me shumë vëmendje situatën politike me të fundit në vend, si dhe duke vlerësuar konsensusin e gjerë publik mbi kërkesat e studentëve, të cilat janë konsideruar nga të gjithë aktorët politikë si të drejta, legjitime dhe të realizueshme, duke synuar interesin më të mirë në përmbushjen e objektivave sociale të parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës, si dhe në garantimin e stabilitetit në vend, me dekretin nr. 10997, datë 13.12.2018 ka vendosur "Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", me qëllim rishqyrtimin e tij. Presidenti i Republikës ka besimin e plotë se Kuvendi i Shqipërisë do të reflektojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës, me qëllim plotësimin e kërkesave të studentëve dhe interesit publik", thuhet në njoftimin e presidentit. Ditën e mërkurë, LSI deponoi në Kuvend dy amendamente me qëllim që të plotësoheshin kërkesat e studentëve. Por, edhe pse Kuvendi nuk e mori parasysh kërkesën, LSI kërkonte nënërin prej amendamenteve që të bëhej një ndryshim në ligjin e buxhetit.

### REAGIMI

Kryeministri Edi Rama reagoi me një postim në "Twitter" lidhur me kthimin e ligjit të buxhetit në Kuvend nga presidenti. Ai ironizoi Metën, duke shprehur çudinë sesi ky hap i tij ndërmerret menjëherë pas propozimeve



Presidenti Ilir Meta

### EDI RAMA

Kryeministri shkruan se Presidenti Ilir Meta e ktheu buxhetin e Shqipërisë pas prezantimit të kërkesave të LSI. "Interesant! Presidenti kthen buxhetin e Shqipërisë pas prezantimit të kërkesave të LSI-së. Asnjë çudi! Vazhdon pa pushim e në çdo formë, presioni mbi studentët për të qëndruar në kor kundër dialogut. Miq! Dilni nga kurthi i atij kori dhe bëhuni individë që flasin në emër të vetes", tha Rama.

"Hidhni kartat e anëtarësisë së LSI, mbroni fëmijët tuaj"

## Kryemadhi, Ramës: Do ikësh si "kufomë" politike, ke bërë evazion fiskal

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi përdori gjuhë të ashpër ndaj kryeministrit Rama teksa u përgjigj ironisë së tij në lidhje me doktoraturën e saj. Kryemadhi tha nga selia e LSI-së se Ramës po i vjen fundi dhe se ai do të ikë si kufomë politike. "Dhe tani po të them diçka si Monikë. Kur hyre në politikë, je fshehur pas emrit tim si një hije e errët, vazhdon të fshehesh pas emrit tim po prapë si një hije e errët, por do ikësh si kufomë politike, po prapë pas emrit tim si një hije e errët", u shpreh kryetarja e LSI. Sipas Kryemadhit, kjo mazhorancë përfaqëson krimin. Ajo paralajmëroi bërjen publike të disa dokumenteve që e përfshijnë kreun e qeverisë në një evazion fiskal, sipas saj, të një kompanie naftë me vlerë deri në 60 mln euro në vit. Drejtuesja e LSI shtoi se, "prete me padurim



### AKUZA

"Harroni flamurin e partisë, merrni flamurin kombëtar në dorë, dilni dhe mbroni fëmijët tuaj, mos kini frikë nga kompleksi i Edi Ramës, mos kini nga dhuna psikologjike dhe nga mediat e blera prej Edi Ramës.

formimin e Byrosë Komitetare të Hetimit, organ që sipas Kryemadhit, hetimin e parë do ta bëjë ndaj Ramës për aferën korruptive tek Unaza e Re. Dhe po të them, tashmë që u ngritën institucionet e drejtësisë, që mundoheh të kapësh, do të ngrihet SPAK-u dhe Byroja e Hetimit, të cilat i pres me padurim të hotojnë aferën tënde të fundit, se nuk është kjo më korruptivja, por ke edhe të tjera. Aferën tënde të fundit se si në xhepin tënd ke future 30 milionë euro në një ditë, 18 milionë euro të

Unazës së Re nën emrin e Bashkim Mulajt, 12 milionë euro prapë në emrin e Bashkim Mulajt me OST-në dhe po të them që do të ketë prapë prapë të tjera dokumente se si ti bën evazion fiskal vetëm në një kompani naftë 60 milionë euro, në 6 vjet kryeministër. 360 milionë euro dhe ja ku i ke ato para, të cilat ti jo vetëm 5% të buxhetit, por edhe 10% të buxhetit ti mund t'ua japësh studentëve shqiptarë", tha Kryemadhi.

të LSI për amendimet. Rama përsërit sërish ftesën ndaj studentëve për dialog. "Interesant! Presidenti kthen buxhetin e Shqipërisë pas prezantimit të kërkesave të LSI-së. Asnjë çudi! Vazhdon pa pushim e në çdo formë, presioni mbi studentët për të qëndruar në kor kundër dialogut. Miq! Dilni nga kurthi i atij kori dhe bëhuni individë që flasin në emër të vetes", deklaroi z.Rama. Por, pas deklaratës së kryeminis-

trit, reagoi zëdhënësi i presidentit, Tedi Blushi. Z.Blushi në një postim në "Facebook" shkruan se reagimi i Metës për të kthyer buxhetin erdhi pasi kanë dëgjuar kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla. "Ja kur erdhi reagimi i Presidentit Meta për çështjen e Buxhetit. Pjesë nga deklaratat e sotme në Kuvend e kryetarit të grupit parlamentar të PS, z.Taulant Balla: Si ta ndryshoj një buxhetin Petrit, kur

buxheti është tek Ilir Meta? Buxheti sot është tek Ilir Meta, nuk është në Kuvend. Është te Presidenti i Republikës. Të gjithë e dini që procedura e ndryshimit të buxhetit është një procedurë që nuk bëhet me dy gisht letër, po kjo është tallje. 28 vjet tallje dhe doni të bëni edhe 28 minuta tallje me studentët këtu në sallën e parlamentit", thuhet në reagimin e zëdhënësit të presidentit, z.Tedi Blushi.

**ILIR META**  
"Vendimi u mor duke ndjekur me shumë vëmendje situatën politike me të fundit në vend, si dhe duke vlerësuar konsensusin e gjerë publik mbi kërkesat e studentëve, të cilat janë konsideruar nga të gjithë aktorët politikë si të drejta, legjitime dhe të realizueshme. Presidenti ka besimin e plotë se Kuvendi do të reflektojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës, me qëllim plotësimin e kërkesave të studentëve".



## Mosdekretimi, Braçe: Meta s'është në Shqipëri, kur e lexoi buxhetin?

Presidenti Meta riktheu dje për shqyrtim ligjin për buxhetin pas protestës dhe kërkesave të studentëve për arsimin. Por, kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe thotë se ligji u dërgua vetëm dje në Presidencë, ndërkohë që Meta ndodhet jashtë vendit dhe sot u shpreh duke e rikthyer. Braçe ngre pyetjen si e shqyrtoi presidenti kaq shpejt buxhetin. Sipas tij, vendimi reflekton qëllime të pastra partiake duke e lidhur me LSI-në. "Kam një pyetje kush president? Ku është dekreti i presidentit? Ky është njoftim për shtyp. Ligji për buxhetin e shtetit të vitit 2019 është dorëzuar dje paradite i zbardhur nga Kuvendi, datë 12.12.2018. Këtu nuk është firma e presidentit. Ky shtet nuk është serioz. Ligji është dorëzuar dje. Tani kam dy gjëra: presidenti është larguar dje nga vendi, ndërkohë që ky dokument është dorëzuar, presidenti nuk ka qenë në zyrë. Kjo tregon mungesë serioziteti. Presidenti nuk është në Shqipëri, si e ka shqyrtuar? Kjo një pyetje akoma më e madhe se firma. Ligji është dorëzuar dje, ai nuk ka qenë në zyrë. Si e mori informimin për buxhetin e arsimit të lartë? Vendimi reflekton qëllimi të pastra partiake. Nuk e kam hallin fare te firma apo dekretimi në mungesë. E kam hallin në mungesë totale të shqyrtimit, nëse gjërat dekretohen pa u shqyrtuar, kjo është fatkeqësi e madhe për këtë vend. Nëse presidenti do të kishte njohur me detaje buxhetin nuk do ta kishte kthyer, sikur pretendon LSI, ish-partia e presidentit. Edhe prej andej më vjen mosnjohja e akteve të buxhetit", - deklaroi z.Braçe.



Ngjarja mori shkas nga prishja e pazareve të drogës, në kërkim 4 të tjerë

TIRANË

Një tjetër person i shpallur në kërkim për ngjarjen e rëndë të ndodhur më 4 tetor të këtij viti në zonën e ish-Bllokut, ku mbeti i vranë 28-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinaj e Eljon Hato, ka përfunduar në pragat e policisë së Tiranës. Bëhet fjalë për Fabiol Alushin, i cili u arrestua pas më shumë se dy muaj në arrati. Mësohet se 42-vjeçari, banues në kryeqytet, mik i Ervin Matës dhe i komandos Merviol Bilo është arrestuar mbrëmjen e së mërkurës në një operacion sekret nga policia, ndërsa akuzohet për vrasje, vrasje e mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje. Burime nga policia dhe prokuroria bëjnë me dije se Alushi ka qenë i pranishëm mbrëmjen e 4 tetorit, kur në lokalin "Monopol", në pronësi të Redi Popeskut ndodhi masakra me një të vranë dhe dy të plagosur. Ndërkohë, vijojnë të jenë në kërkim në lidhje me këtë ngjarjeje i fejuari i këngëtares së njohur Elvana Gjata, Ervin Mata, i cili dyshohet se është arratisur jashtë vendit; Merviol Bilo, i cili i ka shpëtuar një operacioni policor pak ditë më parë; biznesmeni Eldi Dizdari si dhe një ish-efektiv policie, që mbrëmjen e 4 tetorit hyn dhe del lirish nga lokali "Monopol", ndërsa në kokë mbante kapele. Ndërsa, këngëtarja Elvana Gjata nuk është më në kërkim policor, pas përfundimit të afatit 30-ditor. Ngjarja dyshohet të ketë si shkak prishjen e pazareve të drogës mes Ervin Matës dhe biznesmenit Eldi Dizdari, i shpallur në kërkim më 28 nëntor, i dyshuar nga policia si personi i kyç për ngjarjen në fjalë.

# Masakra me 1 të vranë e 2 të plagosur në ish-Bllok, arrestohet Fabiol Alushi

## 42-vjeçari, mik i Ervin Matës dhe i komandos Merviol Bilo u kap në një operacion sekret



I arrestuari Fabiol Alushi

### BIZNESMENI DIZDARI

Hetimet e kryera nga policia dhe prokuroria në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur më 4 tetor të këtij viti në zonën e ish-Bllokut, ku mbeti i vranë 28-vjeçari Fabian Gaxha dhe u plagosën Ervis Martinaj e Eljon Hato kanë nxjerrë në "skenë" një tjetër person. Bëhet fjalë për biznesmenin Eldi Dizdari, i cili është shpallur në kërkim nga policia. Sipas burimeve nga prokuroria, mësohet se Dizdari ka qenë i pari që është konfliktuar me Ervin Matën dhe kushëririn e Elvana Gjatës, Merviol Bilo. Dyshohet se Mata dhe Dizdari janë konfliktuar për çështjen e një borxhi financiar, borxh i cili nuk ishte shlyer nga Ervin Mata.



këtë konflikt është përpjekur të hyjë dhe komandoja Merviol Bilo, por nga pamjet filmike ka rezultuar se Bilo largohet nga Mata dhe më pas Eldi Dizdari së bashku me personat e tjerë që ishin me të janë larguar. Makina e tyre është ndjekur në këmbë nga Mata dhe grupi i tij deri tek zona e "Sky Tower", por nuk kanë mundur me ta shikojnë dhe janë rikthyer sërisht pas, duke u futur në lokal "Monopol". Ndërkohë, Dizdari nuk ka qenë fizikisht në lokalin "Monopol", aty ku ndodhi dhe përleshja fizike me armë, pasi është larguar në drejtim të pacaktuar ende. Pamjet filmike të disa bi-

### ERVIS MARTINAJ

Biznesmeni Ervis Martinaj u arrestua pas masakrës në ish-Bllok, ndërsa ndodhet në arrest me burg pa afat. Përpos akuzave për ngjarjen në lokalin "Monopol", ai akuzohet edhe për pastrim parash. Nga zberthimi i mesazheve telefonike të Martinajit nga ekspertët izraelitë, rezultoi se ai ka qenë i diskutueshëm drejtpërdrejt në këtë ngjarje. Sipas informacioneve të reja të ardhura në prokurori nga shërbimet partnere, rezultoi se Mata nuk i është përgjigjur Dizdarit për një ngarkesë të konsiderueshme droge, gjë që e ka tensionuar raportet mes tyre. Ka qenë Dizdari që i ka thënë Matës se për borxhin duhet të sqarohet me Martinaj.



znesëve sipas prokurorisë kanë zbuluar se Dizdari ka qenë personi i parë ai që është konfliktuar me Ervin Matën dhe më pas është larguar. Pas këtij momenti, pronari i lokalit "Monopol" Redi Popesku thotë se biznesmeni Mata i ka kërkuar leje për të sjellë brenda në lokal Ervis Martinajin, i cili është ulur më pas në banak me personat e tjerë, ku nuk ka votuar shumë dhe ka nisur konfliktin, i cili degjeneroi në përdorimin e armëve. Si pasojë e të shtënave në lokal humbi jetën 28-vjeçari Fabian Gaxha, ndërsa u plagosën dy të tjerë, Ervis Martinaj dhe Eljon Hato (të dy të arrestuar).



Vendi ku ndodhi ngjarja me një të vranë dhe dy të plagosur

### PERSONAT NË KËRKIM

Pas më shumë se dy muajsh nga ngjarja me një të vranë dhe dy të plagosur në zonën e ish-Bllokut, vijojnë të jenë në kërkim i fejuari i këngëtares së njohur Elvana Gjata, Ervin Mata; komando Merviol Bilo, i cili i ka shpëtuar një operacioni policor pak ditë më parë; biznesmeni Eldi Dizdari dhe një ish-efektiv policie që mbrëmjen e 4 tetorit hyn dhe del lirish nga lokali "Monopol", ndërsa në kokë mbante kapele. Ndërsa, këngëtarja Elvana Gjata nuk është më në kërkim policor, pas përfundimit të afatit 30-ditor.



Consultant services for the project "Energy Efficiency Rehabilitation Programme Student City I - Tirana"

Deadline: January 28<sup>th</sup> of 2019

Country: Albania  
Ref.-N°: 201568179  
Prequalification

Ref.: International, open tender for implementation consultant services for the project "Energy Efficiency Rehabilitation Programme Student City I - Tirana".

Tenderer: Ministry of Infrastructure and Energy, the City of Tirana and the Student City Administration (Programme Implementation Unit).

#### Project Objectives:

The objective of the project is to increase the structural integrity, energy efficiency, and basic comfort of the dormitory buildings in Student City I, and university campus located in the South East of Tirana. More specifically, the scope of the works includes (1) modification of present floor plans, (2) refurbishment of the power, heating and hot water supply, (3) improving the access to fire escape ways, (4) interior refurbishment, and (5) end-user training and project visibility measures.

#### Requested Services:

The consulting assignment will generally comprise design, procurement and works supervision (implementation consulting) services required for the rehabilitation of Student City I. More specifically, the implementation consulting services will consist of (1) structural and energy audits, (2) identification of rehabilitation measures, (3) preparation of the final design, (4) preparation of tender documents, (5) supervision of construction works, (6) training of end-users, (7) impact verification and monitoring, (8) qualification and employment opportunities, (9) visibility measures, and (10) reporting.

The scope of the services will be divided into base and optional services, with a total duration estimated at 30 months, excluding the defects liability period. The assignment shall be implemented by a team comprising international and local consultants and other professional and administrative support staff. Additional details regarding the services and the required qualifications of the bidders are provided in the Prequalification Document.

The prequalification of experienced Consultants is subject to the regulations contained in the "Guidelines for Assignment of Consultants in Financial Co-operation Projects" (see www.kfw-entwicklungsbank.de). The contract will be awarded to a consultant firm or a consortium of firms fulfilling the criteria stipulated in the Prequalification Document, including a minimum average annual turnover in the past three years of 1.5 million EUR for a single firm or cumulatively of 1.8 million EUR for a consortium, whereas the lead partner must show a total average annual turnover of at least 1.2 million EUR.

For further information and to obtain the Prequalification Document please contact:

Mr. Alfred Bundo  
Director, Programme Implementation Unit  
Ministry of Infrastructure and Energy of Albania  
Address: Rr. "Abdi Toptani" Nr.1,  
Tirana, Albania 1001  
E-mail: alfred.bundo@infrastruktura.gov.al  
Phone: +3554 2222245/74117





Table with columns for names and numbers. Includes entries for DALINA, VASIL, MURANA, DHIMITER, VASIL, DHASKALI, 11478, HYSEN, MUSTAFA, HARIZI, etc.


Table with columns for names and numbers. Includes entries for VERONIKA, PRENG, GJERGJI, FLORA, PRENG, NOKAJ, GHENARIN, PRENG, NOKAJ, etc.

Table with columns for names and numbers. Includes entries for JANULLA, MIHAL, ZOTO, 6763, LIJ, ZEF, NDOCI, AGETINA, ZEF, PRELA, etc.

Table with columns for names and numbers. Includes entries for GERARDO, XHEHAD, DEMA, 1879, SHABAN, ADEM, THACI, LIMAN, ADEM, THACI, etc.

Table with columns for names and numbers. Includes entries for PETRIT, EMIN, PETRITI, KOÇI, EMIN, PETRITI, ESMÀ, EMIN, PETRITI, etc.

Table with columns for names and numbers. Includes entries for ARBEN, GJON, MAKÀ, 5048, BARDHOK, ZEF, CARA, GHJELNE, ZEF, NDRËCA, etc.



**Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET**

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

**A. Project Background**  
Within the context of bilateral development cooperation, the Republic of Albania and the Federal Republic of Germany agreed on the joint implementation of the "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" program (short: ProSEED) in 2016. The overarching aim is to improve the employment situation of the workforce and self-employed, particularly of skilled youth, in the Albanian labor market.

The program currently runs from 01/2017 until 03/2022 and has five components: (i) Technical and Vocational Education and Training (TVET), (ii) Promotion of micro, small and medium-sized enterprises (MSMEs), (iii) Social participation of youth and minorities, (iv) Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment and (v) Promotion of the innovation system.

In 2018 the European Union (EU) contributed funds under the framework of the Instrument for Pre-Accession Assistance 2020 for the Competitiveness and Innovation (C&I) Sector. The delegated agreement-based co-financing extended the program by including measures to encourage innovative start-ups and to strengthening a corresponding environment (ecosystem) for start-ups and growing companies. As such, a fifth component (see above) was added to the ProSEED program.

One line of intervention within this component delivers advanced capacity development to innovative start-ups (including those owned and/or led by women). Start-ups at different levels of their development are selected upon their innovation and competitiveness potential in a competitive procedure. They will be supported on innovation management and in the field of advanced entrepreneurial skills. Furthermore, they will receive mentoring support for developing their product ideas and scaling-up. For this line of intervention, the position of an Advisor – Start-up promotion is hereby advertised.

**GIZ Office Albania seeks the following staff: Advisor – start-up promotion**

**The advisor – start-up promotion performs the following tasks:**

**B. Tasks**  
Capacity development interventions for Start-ups  

- Coordinates and accompanies the implementation of capacity development interventions for start-ups in the field of innovation management and advanced entrepreneurship support
- Supports the elaboration/definition of selection criteria for start-ups and supports/accompanies the selection process for start-ups for various training modules
- Develops a strategy for the support of women-led start-ups and respective support programmes; coordinates capacity development interventions and support structures/institutions for women-led start-ups
- Based on identified capacity development needs of start-ups: sub-contracts and coordinates external experts on specific Capacity Development / training issues

**Networking**  

- Networks actively on behalf of GIZ in the relevant community and brings new expertise, ideas and trends to the project
- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the project
- Stays in exchange with relevant training and support programmes/interventions from other stakeholders and institutions
- Assists the team leader in establishing and increasing the project's visibility among stakeholders of the start-up community and beyond

**Others**  

- Supports program activities according to project goals, operational planning and agreements with the partner structures. This implies contributing to planning & budgeting, implementation and monitoring of activities
- Accompanies the financial and administrative issues regarding the assigned intervention areas in close coordination with the contract manager of the component.
- Supports the preparation of appropriate input to the various project reports/publications including annual reports in line with EU/GIZ requirements; contributes to other reports as required
- Assists in improving the project's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems

**C. Required qualifications, competences and experience:**  


- Education/training:** University qualification, e.g. in IT, Engineering, Business Administration, Political Science, International Relations, or equivalent
- General professional experience:** at least 5 years of professional experience in developing start-up ecosystems, working in a start-up or participating in a start-up program with a strong focus on innovation and (digital) transformation
- Languages:** Fluent in Albanian, excellent business language skills in English required
- Specific professional experience:** Proven experience in developing innovation ecosystems, experience in private sector development, active member of the Albanian 'start-up scene', experience in the facilitation and creation of networks, applied knowledge in the field of project management

**Contract conditions:**  

- Full-time employment
- Project office in Tirana
- Assignment period: until 30.09.2021

Please forward your application until **25th of December 2018** to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de) including the following information: Application letter, CV in English (Eu-ropass format), references.  
Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPALLJE VENDI VAKANT**

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjykatarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit" shpall 1 (një) vend vakant për "Drejtor" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT:**

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME:**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:**

- Paraqitës së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me letë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al). KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.**



**BalkanWeb.com**  
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

**BalkanWeb.com**  
**BW**  
FALAS



Kosova do të hapë rrugën për krijimin e ushtrisë së vet. Serbia kërcënon me reagim ushtarak

# Kosova do ushtri të vetën, Serbia kërcënon

*Spirale e përshkallëzimit verbal dhe faktik mes Serbisë dhe Kosovës*

**K**osova që nga nëntori ka rritur me 100 për qind tarifat doganore për importet nga Serbia. Një reagim ky ndaj pengimit që i bëri Serbia anëtarësimit të Kosovës në Interpol pak më parë. Këto imponime reciproke krijojnë uverturën e një ashpërsimi kërcënues të krizës mes serbëve dhe kosovarëve. Ndërsa BE-ja shityn sërish liberalizimin e dëshiruar prej kohësh të vizave për qytetarët e Kosovës, që gjë e ushqen edhe më shumë zhgënjimin prej BE-së. Etapa pasuese e përshkallëzimit kërcënon tani më 14 dhjetor. Parlamenti në Kosovë do të vendosë hapjen e procesit të themelimit të një ushtrie të vetën. Më keq nuk bëhet. Aktualisht, politikanët janë duke bërë fakt të kryer një zgjidhje afatgjatë të çështjes së Kosovës, po kjo është e ndryshme nga ajo që mendojnë ndërmjetësuesit europianë.

## ÇFARË KA NDODHUR?

Pas vitesh të tëra bllokimi në një "konflikt të ngrirë," për herë të parë më 2018 në arenën ndërkombëtare u diskutua dhe u bisedua hapur për këmbim territoresh dhe zhvendosje kufijsh midis Serbisë dhe Kosovës, - një thyerje e madhe tabush në sistemin europian të vlerave! Vetë presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe kolegu i tij kosovar Hashim Thaçi, e hapën këtë temë dhe biseduan për të. Ideja kryesore është, që territoret me shumicë popullore serbe në Veri t'i (ri)jepen Serbisë, kurse territoret me shumicë shqiptare në Jug të Serbisë t'i jepen Kosovës.

Askush nuk flet më zyrtarisht për këtë lloj zgjidhjeje, pas një grindjeje të ndodhur gjatë një takimi të zhvilluar në Bruksel në verë, nga i cili presidenti serb u largua me zemërim, për të dalë disa ditë më vonë përpara popullsisë serbe në Veri të Kosovës, e për ta përbetuar atë ndaj kursit të njohur prej kohësh: Kosova është Serbi. Asnjë gjurmë për kompromis nuk duket. Ndërsa në Kosovë presidenti Thaçi, u kritikua ashpër nga qeveria për planet e tij të ndarjes. Kryeministri Ramush Haradinaj, me të cilin Thaçi ka qenë bashkëluftëtar në luftën e Kosovës, mobilizoi politikën dhe publikun kundër këmbimit të territoreve.

Por, me gjithë paralajmërimet e shumta nga politika europiane, kryesisht nga Gjermania, për të mos ven-

dosur kufij etnikë, tema nuk është hequr nga tavolina. Herë pas here thuhet se Vuçiq dhe Thaçi, vazhdojnë bisedimet. Ndërkohë ndikimi i BE-së, që drejtoi për vite me radhë dialogun midis vendeve, është duke rënë dukshëm: Për shtetet e Ballkanit nuk ekzistojnë më stimujt tërheqës dhe sigurisht as shumë potencial kërcënues: Perspektiva e pranimit të Serbisë, që në fillim të vitit u tha jo fort e qartë për vitin 2025, nuk përmendet sot prej askujt në Bruksel me ndonjë datë konkrete. Edhe në Kosovë, e cila nuk është njohur ende si shtet i pavarur nga pesë vende anëtare të BE-së, nuk ndihet më euforia e dikurshme për BE-në, pas shtyrtjes për të disatën herë të liberalizimit të vizave, megjithëse vendi i ka plotësuar kushtet. Kështu popullsia kosovare mbetet e vetmja në rajon, që vazhdon të mos lejohet të udhëtojë e lirë "për në Europë".

## ZHGËNJIMI I KOSOVARËVE

Zhgënjimi i kosovarëve është shumë i madh. Të gjithë kosovarët kanë familjarë në Gjermani, ose në ndonjë vend tjetër të BE-së. Kosova jeton prej lëvizjeve midis këtyre dy botëve. Rrugëzgjdhja e vetme është një pasaportë, që siguron lirinë e udhëtimit. Këtë pasaportë e ka fqinj jugor, Shqipëria. Kryeministri shqiptar Edi Rama, u pati premtuar hapur kosovarëve se do t'u japë pasaportën shqiptare, nëse BE

### ZHGËNJIMI

Zhgënjimi i kosovarëve është shumë i madh. Të gjithë kosovarët kanë familjarë në Gjermani, ose në ndonjë vend tjetër të BE-së. Kosova jeton prej lëvizjeve midis këtyre dy botëve. Rrugëzgjdhja e vetme është një pasaportë, që siguron lirinë e udhëtimit. Këtë pasaportë e ka fqinj jugor, Shqipëria.



### ALEATET AMERIKANE

Ambasadori i SHBA-së, ndryshe nga përfaqësuesit e tjerë të NATO-s, është shprehur tashmë pozitivisht për krijimin e ushtrisë. Një qëndrim disi më të rezervuar ka shprehur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg.

## INTERESAT NDERKOMBËTARE

Nuk përjashtohet mundësia që zhvillimet e javëve të fundit të çojnë në ndarjen faktike të Kosovës, dhe në afat të gjatë krijimin e një federate të pjesës së mbetur të Kosovës, me Shqipërinë. Analistët dhe politikanët e rajonit janë duke luajtur tashmë me këtë skenar. Një përfytyrim traumatik ky për serbët. "Shtëpia e varfër Kosovë" ndonëse ekonomikisht nuk ka ndonjë domethënie të madhe për Serbinë, rëndësia e saj është e argumentuar më shumë në mënyrë emotive se sa racionale, duke e ankoruar fort Fushë Kosovën në memorjen kolektive të serbëve si bërthamën historike të Serbisë.

refuzon sërish liberalizimin e sistemit të vizave. Koha për këtë ka ardhur.

Edhe diçka tjetër i ofron Shqipëria fqinjit verior: lidhjet ekonomike. Me këtë Shqipëria bëhet një alternativë e fortë ndaj Serbisë, prej së cilës Kosova ka qenë deri tani e varur ekonomikisht. Por, kur Serbia pengoi Kosovën të bëhet anëtare e Interpolit, Kosova menjëherë rriti tarifat doganore mbi mallrat serbe, duke paralajzuar thuasë krejtësisht importet. Pavarësisht nga thirrjet dhe paralajmërimet e ndërmjetësuesve dhe ekspertëve ndërkombëtarë, qeveria kosovare vazhdon të këmbëngulë në vendimin e saj, duke prerë kështu linjat më të rëndë-

sishme të tregtisë nga Serbia. Boshllëkun e krijuar plotëson tani Shqipëria.

Pak ditë pas fillimit të konfliktit doganor, në qytetin kosovar të Pejës u zhvillua një takim që tërhoqi vëmendjen: Më 26 nëntor qeveria e Kosovës dhe e Shqipërisë u takuan nën moton: një popull, një gjuhë, një ëndërr. Të dy kabinetet qeveritare ranë dakord për synimet e përbashkëta dhe me ndikim të gjërë në fushën politike, ekonomike dhe kulturore: Së bashku në rajon dhe drejt Europës, me dy koka, por me një zë, ish. të mesazhi i qartë dhe patetik i takimit, që politikanët e manifestuan me një fotografi në grup, duke bërë simbolin e shqiponjës

dykrenare shqiptare. Një simbol i urryer ky në Serbi.

Ky solidaritet me Shqipërinë do të thotë një dinamike e re në rajon: Kosova tani do të bëhet e pavarur nga Serbia jo vetëm politikisht, por edhe ekonomikisht. Ata që vuajnë janë serbët e Kosovës veriore, që janë shpërndarur nga Serbia, por refuzojnë edhe futjen në strukturat kosovare. Kufijtë etnikë brenda Kosovës janë thelluar.

## INTERESAT E RUSËVE DHE TË AMERIKANËVE

Nuk përjashtohet mundësia që zhvillimet e javëve të fundit të çojnë në ndarjen faktike të Kosovës, dhe në afat të gjatë krijimin e një federate të pjesës së mbetur të Kosovës, me Shqipërinë. Analistët dhe politikanët e rajonit janë duke luajtur tashmë me këtë skenar.

Një përfytyrim traumatik ky për serbët. "Shtëpia e varfër Kosovë" ndonëse ekonomikisht nuk ka ndonjë domethënie të madhe për Serbinë, rëndësia e saj është e argumentuar më shumë në mënyrë emotive se sa racionale, duke e ankoruar fort Fushë Kosovën në memorjen kolektive të serbëve si bërthamën historike të Serbisë.

Edhe vringëllimat e shpatave i përshatan kësaj perspektive: Serbia kërcënon me luftë, nëse Kosova do të vendosë të premtën krijimin e një ush-

trisë të vetën dhe do të dërgojë trupa në veri. Edhe nëse në Kosovë janë dislokuar katër mijë ushtarë ndërkombëtarë të KFOR-it, që duhet të sigurojnë kufijtë dhe paqen, nuk përjashtohet mundësia e një aksioni të Serbisë për mbrojtjen e popullsisë serbe në veri. Kështu të paktën kërcënon kryeministria serbe, Ana Brnabić: "Unë shpresoj, që ne asnjëherë të mos na duhet të mobilizojmë ushtrinë", formulon ajo me vetëdije në mënyrë e vazhde. Kështu do të realizohej faktikisht postimi i kufijve, sikurse janë duke diskutuar politikisht Vuçiq dhe Thaçi.

Ndonjë përshkallëzim tjetër ushtarak i situatës ka pak gjasa që të ndodhë, sepse Kosova ndodhet nën mbrojtjen direkte të Amerikës, duke pasur me Bondsteel-in një nga bazat më të mëdha amerikane jashtë SHBA-së. Ambasadori i SHBA-së, ndryshe nga përfaqësuesit e tjerë të NATO-s, është shprehur tashmë pozitivisht për krijimin e ushtrisë. Një qëndrim disi më të rezervuar ka shprehur Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. Themelimin e ushtrisë ai do ta marrë si shkas për të rishqyrtuar angazhimin e NATO-s në këtë vend. Më alarmuese tingëllojnë tonet nga Moskua, sipas së cilës: Krijimi i një ushtrie kosovare mund të kishte pasojë të rënda jo vetëm për popullsinë serbe në rajon, por edhe për sigurinë në mbarë Ballkanin."

"Miss Shqipëria 2018" ja për çfarë do të mbahem mend

# Alba Bajrami:

## Emocionet e kurorës, synoj të hyj në botën e televizionit

*"Nuk kam ndonjë sekret për linjat perfekte, është gjenetike"*



ju kam ndenjur afër për çdo gjë.

**Oferta më e çuditshme që të kanë ofruar për të dal në ekran?**

Nuk ka pasur oferta të çuditshme për mua. Kam pasur vetëm oferta serioze.

**E synon televizionin?**

Bota e televizionit më pëlgen shumë dhe në të ardhmen synoj për t'u bërë pjesë e televizionit.

**Pas kompeticionit të bukurisë, ku e sheh veten Alba?**

E shoh veten me shkollën që gjithmonë kam dashur, arkitekturën, gjithashtu, dhe në botën e modelingut që ka qenë ëndërr që kur kam qenë e vogël.

**Do i pranoje setet nudo?**

Jo, pasi nuk ndjem rehat për të bërë sete nudo.

**Sekreti i linjave perfekte?**

Nuk kam ndonjë sekret pasi tek unë është gjenetike, mund të ha çfarë të dua dhe përsëri ngelem kështu siç jam.

**Aventura më e rrezikshme?**

Deri tani nuk kam pasur asnjë aventurë të rrezikshme. Deri më sot kam pasur një jetë mjaft të qetë, por si dihet çfarë të sjell jeta.

**Sa vlerësohet e bukura në Shqipëri?**

Sipas mendimit tim dhe mesa kam parë jo shumë kompeticione të rralla ka si për shembull familja e Delliart që vlerësojnë bukurinë e vajzave kurse të tjerët rreth e rrotull nuk duan t'ia dinë shumë. Sado e bukur të jesh presin që të gabosh që të bëhet lajm.

**Përkufizimi që do i jepje lumturisë?**

Së pari, lumturia është kur sheh familjen të bashkuar dhe kur ndjenë ngrohtësinë dhe dashurinë që ajo të dhuron, por lumturi është dhe kur sheh dikë që kalon çaste të bukura ose kur dikush arrin diçka që është përpjekur aq shumë.

Egla Xhemali

16-vjeçarja me origjinë nga Çamëria mban trofeun e më të bukurës në Shqipëri. Alba Bajrami ndan me ne emocionet e përjetuara kur u përzgjedh si "Miss Shqipëria 2018", përfshirjen në botën e ekranit, setet nudo, sekretin e linjave perfekte, si dhe vlerësimet që i bëjnë të bukurës në Shqipëri. Edhe pse në moshë fare të vogël, bukurshja pohon se kurora mund të jetë një mënyrë që do i hapte rrugën për t'ju futur modelingut, pasionit të saj megjithëse pohon se ëndrra më e madhe që ka është të studioj arkitekturë. Sa i përket seteve nudo Alba thotë se nuk do pozonte kurë. Ajo që do i mbaj mend publiku nga Bajrami është padyshim talenti i saj për skulpturë dhe mirësia që e karakterizon te duke sjellë në kompeticionin e bukurisë një frymë bashkëpunimi të këndshme mes konkurrenteve. Përkufizimi që Alba i jep lumturisë është familja e bashkuar si dhe ngrohtësia që ata i falin. Bukuroshes i pëlqen televizioni. Nuk përjashtohet mundësia që Bajrami të bëhet pjesë e pasarelave të mëdha duke qenë se pasioni për to është i fortë. E bukur në gjithçka! Ne i urojmë Albës rrugëtim plot suksese kudo qoftë!

**Si i përjetove emocionet më të bukurës?**

Emocionet e fitores së kurorës së vajzës më të bukur shqiptare vazhdojnë të jenë po aq të forta si në momentin e parë kur dëgjova emrin tim të thuhet nga juria që unë isha fituesja. E rikujtoj gjithmonë atë moment kur thanë emrin tim dhe më pushtojnë emocionet.



**Momenti më i sikletshëm në pasarelë?**

Nuk para më ndodh të vhem në siklet gjatë kohës që jam në skenë, por ndodhin

dhe gabime të vogla për shembull të bësh ndonjë hap gabim nga emocionet e skenës, më ka ndodhur vetëm një herë kur bëra një hap gabim, po e bëra

që të mos dukesh si gabim, sepse asnjë s'e dinte koreografin tonë.

**Ndihj rivaliteti mes konkurrenteve?**

Rivaliteti mes vajzave është i pranishëm në çdo kompeticion, sepse çdo vajzë vjen për të fituar, por tek "Miss Shqipëria" nuk ishte dhe aq i ndjeshëm rivaliteti pasi të gjitha gocat krijuan një marrëdhënie shumë të mirë shoqërore me njëra-tjetrën.

**Për çfarë do e mbajmë mend Albën e "Miss Shqipëria 2018"?**

Mendoj se diçka që do më bëj mua të mbahem mend tek "Miss Shqipëria" është talenti im për skulpturën dhe gjithashtu është se gjithmonë kam dashur t'i shoh të gjitha vajzat të lumtura dhe mundohesha gjithmonë ti bëja për të qeshur kur rrinim me njëra-tjetrën dhe i kam ndihmuar me çdo gjë që mundesha dhe



## Klea dhe Elgiti paralajmërojnë fansat, zbuloni çfarë po ndodh me artistët

Moderatorja e njohur shqiptare Klea Huta ka publikuar në rrjetet sociale një video, në të cilën tregon se së shpejti do të sjellë një projekt me partnerin e saj Elgjit Doda. Në këtë video çifti shfaqet në poza sensuale dhe romantike me njëri-tjetrin, ndërkohë që Klea ka shkruar: "A jeni gati?? I'm so excited... Mezi presss", -përfundon bukuroshja. Nuk dihet ende se çfarë po përgatisin dy artistët e njohur, të cilët janë edhe një nga çiftet më të dashur të show bizz-it shqiptar.



## Adelina Tahiri mes luksit, këngëtarja poston foto nga dhoma e gjumit

Pas lindjes së djalit, jeta e Adelina Tahirit dhe partnerit të saj ka ndryshuar. Të dy shihen prindër shumë të lumtur, e momente emocionuese shpesh i ndajnë edhe me ndjekësit në rrjetet sociale. Së fundmi, këngëtarja shqiptare ka vendosur që ta ndajë me ndjekësit në "Instagram" pak nga dhoma e saj e gjumit në të cilin shihet edhe krevati i bebes. Fillimet e para të lidhjes së saj me milionerin që tashmë e ka burrë ishin jo edhe të lehta për Adelinen pasi mori kritika shkak se ai është më i vjetër, por ky fakt nuk po e pengon çiftin ta shijojë martesën.



## Klaudia Pepa vijon me deklaratat, mësoni kujt i thotë: "Dashuria ime"

Është një nga balerinat më të njohura në vendin tonë, e cila aktualisht e vijon karrierën e saj në Itali. Por vetëm pak ditë më parë balerina Klaudia Pepa ka qenë, gjithashtu, moderatore e edicionit të 20-të të festivalit "Kënga Magjike". Gjatë ditës së djeshme ajo ka publikuar një foto duke



kujtuar kohët e kaluara në këtë festival. Në këtë imazh ajo ka pozuar me motrën e saj Pamela Pepa duke u dukur të dyja tejet elegante dhe në formë. "Dashuria ime", shkruan Klaudia në rrjetin social "Instagram".

## Pas deklaratave të bujshme, ja ku ndodhet Fjolla Morina

Në një mënyrë apo tjetër, ajo gjithmonë merr vëmendjen e shtypit rozë. Behet fjalë për Fjolla Morinën, e cila së fundmi ka përfunduar në spital, nga ku dhe ka publikuar pamje tekta po bën serum, por që se çfarë ka ndodhur më shumë me të nuk ka treguar. "Smut veç për pak", ka shkruar ajo në videon e publikuar në 'Instagram'. Dy javë më parë emri i saj u lakua shumë në media për deklaratat e lëshuara tek "Shiko kush Luan", duke thënë se Adelina Ismaili është femra, e cila ka më së shumti operacione në estradë, ndërsa për Nora Istrefin ajo tha se kopjon shumë, ndërsa sa i përket Tunës ajo tha se është këngëtarja e cila ka bërë lëmsh gjithë estradën me thashethemet e saj. Madje Fjolla u shpreh se Tuna duhet të heqë dorë nga muzika!



Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

# Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

## ALUIZNI publikon listën e përfutësve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj

Këshilli i Ministrave ka miratuar pardje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtetas, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë,

Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfutësve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m<sup>2</sup> dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga

ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

### AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Numri i Pronareve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve					
Emër	Atësi	Mbiemër		Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
TIRANË VERI									
QARKU TIRANË ZVRRP TIRANË, ZONA KADASTRALE 2679									
			1	NADIRE		PELLUMBI			
			2	EMINE		PULAJ			
			3	MERJEM		DURDA			
			4	LIRIJE		DAKA			
			5	GJERAQIN		SKENDERAGA			
			6	IRENA		PELLUMBI			
			7	GENTI		PELLUMBI			
			8	IRIS		PELLUMBI			
							229.1	4.242	971.842.20
ENVER	NEZR	KADRIU							
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 3321, ZVRRP TIRANË									
HATMAN	ELEZ	KOJELI	9	HAXHI		PELLUMBI	434.2	2560	1,111,552.00
MALIQ	MASAR	DOÇI	10	ZENEL	BAJRAM	DERVISHI	262.6	2560	672,768.00
			11	SHQIPONJ		KUSI			
			12	DANIJELA		KUSI			
			13	GEZIM		KUSI			
			14	KEJSI		KUSI			
QEMAL	QAZIM	PANE					227	2560	581,120.00
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 3866, ZVRRP TIRANË									
PELLUMB	SEFER	MAKSUTA							
GENAM	SEFER	MAKSUTA							
ERHALDO	PELLUMB	MAKSUTA							
URAN	PELLUMB	MAKSUTA							
EURIAL	PELLUMB	MAKSUTA							
			15	SHKELQI M	AVDI	KOÇAJ	340.4	4242	1,443,976.80
AGIM	ENVER	RAMA	16	BARDHYL	SYRJA	KARALLIU	276.00	4,242	1,170,792.00
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronareve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve					
1	2	3		Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			17	ARBEN	GANI	LIKA	44.00	4,242	186,648.00
			18	ANILA		LLAGAMI			
			19	AIDA		LLAGAMI			
			20	MIRELA		DIMROCI			
			21	SHKENDIE		LLAGAMI			
			22	MELEQE		LLAGAMI			
			23	QEMAL		LLAGAMI			
			24	DASHURI		LLAGAMI			
			25	DENIS		LLAGAMI			
			26	HELIDON		LLAGAMI			
			27	ETLEVA		LLAGAMI			
			28	BLEDAR		LLAGAMI			
			29	FATBARD HA		LLAGAMI			
			30	DIANA		DHAMO			
			31	AFERDITA		LLAGAMI			
			32	QAMIL		PANARITI			
			33	BARDHYL		LLAGAMI			
			34	DYLBERE		LLAGAMI			
			35	BUJANA		LLAGAMI			
			36	DORIAN		LLAGAMI			
			37	MIRANDA		NOSI			
			38	MERITA		LLAGAMI			

ELTON	SHAHIN	SHEHU	39	KLEJDA		LLAGAMI			
			40	DEA		LLAGAMI			
			41	HAJDE		LLAGAMI			
			42	VIRIL		LLAGAMI			
			43	DIVIN		LLAGAMI			
			44	MIRADOR		LLAGAMI			
			45	ENIDA		LLAGAMI			
			46	SHOIQE		KOVACI			
							124.00	4.242	526,008.00
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 3976, ZVRRP TIRANË									
EQEREM	ADEM	SPAHIU	47	YLLI	ISUF	LULI	117	479	56,043.00
			48	ILIR	HYSEN	DODA	6.9	479	3,305.10
QARKU TIRANË, ZONA KADASTRALE 8110, ZVRRP TIRANË									
			49	ABDULLA	HAMIT	MYFIU			
Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar									
Emër	Atësi	Mbiemër	Numri i Pronareve që kompensohen	Kompensimi i Pronarëve					
1	2	3		Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m <sup>2</sup> )	Çmimi (leke/m <sup>2</sup> )	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
			50	AFERDITA	RAMAZAN	BASHA			
			51	AGIM	REXHEP	BASHA			
			52	AHMET	HAMIT	MYFTIU			
			53	AHMET	RAMAZAN	BASHA			
			54	EMINE	REXHEP	BASHA			
			55	ENGJELLU SHE		KOKONOZI			
			56	EQEREM	HAJDAR	BASHA			
			57	FITNETE	SHAQIR	BASHA			
			58	GJYLE	SEFER	BASHA			
			59	HAMIT		KOKONOZI			
			60	HATDHE	HAMIT	KRETANI			
			61	ISMETE	HAMIT	MYRTERZI			
			62	LAVDIE		KOKONOZI			
			63	LEJLA		KOKONOZI			
			64	LUAN	RAMAZAN	BASHA			
			65	LULJETA		KOKONOZI			
			66	LULZIM	RAMAZAN	BASHA			
			67	MIMOZA		KOKONOZI			
			68	MUHAMET	HAJDAR	BASHA			
			69	NAILE	RAMAZAN	BASHA			
			70	QEMAL	HAJDAR	BASHA			
			71	RIZA		BASHA			
			72	SADIK	HAMIT	MYFTIU			
			73	SHOIQE	ZYBER	BASHA			
			74	SKENDER	REXHEP	BASHA			
ALFRED	DAJLAN	HABIBASI	75	YLBER		KOKONOZI	205	23703	4,859,115.00
			76	BUJAR		BEKA			
			77	FATIME		BEKA			
			78	HASAN		BEKA			
			79	HYSEN		BEKA			
RIZA	QAMIL	HOXHA	80	BLIJAR		BEKA	382.8	23703	9,073,508.40
			81	FATIME		BEKA			
			82	HASAN		BEKA			



Table with 6 columns: No. (197-211), Name (MAJLINDA, MEHMET, MELEQE, MERITA, MUSTAFA, OSMAN, OSMAN, SADIK, TEFIK, VJOLLCA, ZYHRA, ZYRA, ADUARD, AFERDITA, AGIM), Address (MUJOLLI, BYLYKBASHI, MUJOLLI, KUKA, KUKA, KUKA, MUJOLLI, BYLYKBASHI, HUQI, KUKA, VRAPI, KUKA, KUKA, MUCA).

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, Numri i Pronareve qe kompensohen, Emër, Adesi, Mbiemër, Masa e kompensimit (m²), Çmimi (leke/m²), Shuma - Viera e kompensimit (lek). Rows 1-211 with summary at bottom: 444.40, 33,755, 15,000,722.00.

Table with 6 columns: No. (260-279), Name (MYSRET, OSMAN, OSMAN, QEFSERE, RESHAT, REXHEP, SADETE, SADIK, SAIMIR, SAIMIR, SEIT, SEMHA, SHABAN, SHPRESA, SLIZANA, TEFIK, VJOLLCA, ZYHRA, ZYRA, ZYRHA), Address (MUCA, KUKA, MUJOLLI, KUKA, KUKA, MUCA, MUJOLLI, KUKA, KUKA, KUKA, XHELEPI, KUKA, MUCA, MUCA, BYLYKBASHI, HUQI, VRAPI, VRAPI, KUKA).

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, Numri i Pronareve qe kompensohen, Emër, Adesi, Mbiemër, Masa e kompensimit (m²), Çmimi (leke/m²), Shuma - Viera e kompensimit (lek). Rows 1-2 with summary: 331.30, 33,755, 11,183,031.50.

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8230, ZVRPP TIRANE

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, No. (283-292), Name (BAJRAM, BEDRI, BLEDAR, BUJAR, ENVER, FATOS, GANI, HASAN, ILIR, KASEM), Address (HAMIT, LATIF, LATIF, LATIF, LATIF, LATIF, HAMIT, QERIM, LATIF, HAMIT), Address (XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA, XHAMETA), Summary: 31.60, 23,703, 749,014.80.

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260, ZVRPP TIRANE

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, No. (293), Name (YMER, MALIQ, DASHI), Address (MBIVENDOSJE), Summary: 251.40, 30,783, 7,738,846.20.

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8310, ZVRPP TIRANE

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, No. (294-306), Name (ALMA, ARBEN, BRIKENA, DURIM, FATMIRA, HYSEN, KUJTIM, LINDITA, MUHAMET, PETRIT, QEFSERE, SKENDER, VJOLLCA), Address (KOKOLJ (MYFTIU) SINA, KOKOLJ (MURATI) KOKOLI, SHPATI, SHPATI, KOKOLJ, SHPATI, SHPATI, SINA, SHPATI, SHPATI, SHPATI, SHPATI, SHPATI, SHPATI), Summary: 500.20, 31,219, 15,615,743.80.

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8320, ZVRPP TIRANE

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, No. (294-299), Name (KUME, KUME, LAJE, LIRIJE, LULIETA, LULIETA, LULZIM, MAJLINDA, MEHMET, MELEQE, MERITA, MIMOZA, MUSTAFA), Address (MUJOLLI, MUJOLLI, KUKA, KUKA, MUCA, VYSHKA, MUJOLLI, BYLYKBASHI, MUJOLLI, MUJOLLI, KUKA, KUKA), Summary: 1,238.80, 31,219, 38,674,097.20.

QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8320, ZVRPP TIRANE

Table with 10 columns: Emër, Adesi, Mbiemër, No. (307-312), Name (MALIQ, NERIMAN, YLBER, ABAZ, FATMR, HALIT), Address (OSMAN, MALIQ, MALIQ, MALIQ, MALIQ, IMER), Address (CEJKU, CEJKU, CEJKU, CEJKU, CEJKU, BIBA), Address (ZHULETA, FREDERIK, KLAUDJA, SULEJMAN, HOXHA, HAJREDIN, SKENDER), Address (SINA, GJERASI, TOTO, HOXHA, HOXHA, HOXHA), Summary: 439.60, 31,219, 13,723,872.40.









Opinion i Ditës

# Si kurohet universiteti gjobëvënës?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... Studentët u ngritën se abuzimi nuk durohej dot më. Sfiduan të ftohtit për të përmbysur trajtimin e tyre si lopë për t'u mjellë nga një administratë universitare e korruptuar dhe e paaftë. Nga tarifa të rritura me 240 për qind në pesë vitet e fundit. Nga 370 euro pagesë tarife vjetore për studentë, që shndërrohet edhe mbi 1 mijë euro në vit, nga pagesat e detyruara nën dorë arsimtarëve të korruptuar.

Nëse të 16 universitetet publike u marrin tarifa zyrtare të 128 mijë studentëve rreth 18 milionë euro në vit, dyfishin e "vjelin" pedagogët abuzues me zarfat-gjoha. Këta janë pedagog çakenj, tregtarë dijesh e të zvetënuar, që përgatisin provime enkas me pyetje gati të pamundura për t'u përgjigjur, që sekserët të kenë më shumë sukses në shitjen e tyre tek studentët e dëshpëruar. Sistemi ynë i arsimit të lartë publik ka me qindra arsimtarë dinosaurë që nuk shpenzojnë në internet qoftë edhe një minutë në ditë për t'u riaktësuar me dijet e reja të lëndës së tyre, që ndihen bejlerë të patrazuar në fushën e dijes ku e konsiderojnë veten ekspertë absolutë, pse askush nuk i teston sa u vlen lekura dhe spaletat "doktor/profesor/profesor i asociuar", etj. Kjo që po jetojmë këto ditë është kryengritje për përmbysje dhe na fton të gjithëve në rrugë, aty ku në të ftohtë po konsumojnë sakrificën e tyre studentët. Qeveria nuk duhet ta cilësojë "mos-arësyje" refuzimin e studentëve për të biseduar me të. Ai është guri i çmuar, zafiri i rezistencës së tyre.

Pse studentët kanë të drejtë të jenë mosbesues me qeverinë. Është e njëjta qeveri që miratoi katër vite më parë një ligj të arsimit të lartë, fort të mirë në dukje, efektiv



për universitetet publike gjermane ose franceze, por që prodhoi gjëmën financiare për të 128 mijë studentët e arsimit të lartë publik të vendit tonë. Pse, pa prekur mediokritetin e përgatitjes dhe cilësinë e ulët të mësimdhënies në auditorë tanë, gjeneroi në këto 1288 ditë (nga 22 korriku 2015 kur u miratua) sistemin më monstruoze të gjobvënies për studentët e arsimit të lartë publik, kryesisht të ardhur nga familje me të ardhura të mesme dhe të pakta të shoqërisë sonë, pra nga shumica e familjeve shqiptare. Janë rreth 90 milionë euro gjoha provimesh që ky sistem

u ka zhvatuar familjeve shqiptare në këto tre vite universitare. Pa përmendur 48 milionë eurot e tarifave zyrtare të paguara deri tani, që bëhen aq lehtësisht 5 milionë euro në vit (vetëm Universiteti Shtetëror i Tiranës) pagesa për roje sigurie, apo makina të blera 76 mijë euro për dekanët tanë.

Kryeministri që bëri publike dhe këto shifra skandalozë duhet të kuptojë se arsimit ynë i lartë shtetëror dhe të 16 universitetet e tij nuk shpëtojnë dot nga paraliza pa një kujdestari të fortë e të përkohshme. Dhe kujdestar shtetëror duhet të jetë pikërisht ai dikaster që

në emër të autonomisë universitare i la drejtuesit e këtij sistemi të rrjepin studentët, të zerojnë kërkimin shkencor dhe të tallen me shërbimet studentore. Stafet e sotme universitare fatkeqësisht nuk mund të bëhen pjesë e zgjidhjes, pse janë shkaktare të sëmundjes, kllapisë vrastare. Ligji i vitit 2015 për arsimin e lartë e tregoi katërcipërisht se ishte i parakohshëm. Duhet ngrirë! Duhet amenduar urgjentisht, që sistemi të punojë nën një kujdestari të fortë të përkohshme. Me kontroll shembullor mbi financat e universiteteve publike, si nga inspektorët

e Ministrisë së Arsimit, edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Me inspektorë cilësie që kontrollojnë nivelin mjeran të sotëm të shumicës së stafit akademik, verifikojnë doktoraturat kalpe e në 80 përqind plagjiatura (kopje) dhe kalojnë në veting të gjithë pedagogët. Qeveria jonë duhet të fillojë nga këto masa, pavarësisht nga zgjatja e protestës studentore. Ia ka borxh këtyre studentëve-prometej kaq gjë. Madje gjithë shoqërisë sonë. Nëse do që ta votojmë në qershor 2021, duhet të kurojë urgjentisht kllapinë-gjobvënien të arsimit të lartë publik sot.

Opinioni *i* Ditës

# Qeveria po bie, i ka vdekur propaganda

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... publik, pasi kamerat e një televizioni grek e filmuan duke harbuar me shpurën e tij në një buzuk të Athinës, ndërkohë që vendi ishte i zhytur në zi kombëtare. Më kot makineria e pushtetit të tij u mundua t'i fshehtë ato pamje, më kot ish-kryeministri u përpoq të thurte alibinë e një problemi shëndetësor. Mjaftoi një lidhje normale për botën e sotme, mes TV "Klan" të dikurshëm dhe homologut të tij grek, që lideri i rikthyer në pushtet në emër të katharsisit të politikës, të përbaltej për gjithmonë.

Sali Berisha e pësoi edhe më keq. Pasi urdhëroi të shtihet mbi turmën duke marrë katër jetë në 21 janar, ai s'la gur pa lëvizur për të fshehur krimin e tij. Me një idiotësi proverbiale u krijuan legjenda sikur viktimat ishin qëlluar nga afër, me thika me helm dhe pistoletat çadra, madje u shfaqën edhe video të manipuluar që e demonstroi këtë.

Por, mjaftuan pamjet tronditëse të gardistit që qëlloi drejt e në mish, të transmetuara me guxim nga Artan Hoxha në "News 24", që i gjithë ky manipulim i ndyrë të bëhej shkruar e hi në pak çaste.

Kjo dramë iu përsërit edhe Edi Ramës.

Në krizën më të thellë që ka pllakosur qeverinë e tij prej 5 vitesh, kur i ka dalë boja si një hajdut me çizme dhe kur me mijëra studentë kanë pushtuar rrugët, ai u mundua të prodhonte një shfaqje të madhe mashtruese. Ndërkohë që protestuesit e refuzojnë me përcënim, ai kërkoi të lërë përshtypjen se ata janë vetëm një grusht i vogël në masën e stërmadhe të 140 mijë studentëve shqiptarë. Për këtë u organizua spektakli i shëmtuar i "Top Show". Për këtë ai shpiku identikitin e një manifestuesi të rremë duke veshur me kostumin e kundërshtarit, freshistët dhe zyrtarët e vet.

Çfarë boomerang-u!

Në rrjetet sociale, ata që ai kishte veshur si gjerman për t'i shitur u partizanë, u demaskuan njëri pas tjetrit, me emër dhe mbiemër. Kulmi arriti kur njëri prej studentëve doli nga skenari duke demaskuar gjithçka dhe duke e detyruar Ramën t'i futej rolin të një klouni banal. Nuk duhej më tepër sesa kaq, për të kuptuar se kësaj qeverie nuk i ka mbetur më armë tjetër përpos mashtrimin dhe manipulimit. Por, nuk duhej më shumë as për marrë vesh se atyre u ka dalë boja. Se koha e propagandës ka shteruar.

Të tria historitë e mësipërme, krejt të ndryshme për nga lloji



dhe simbolika, i përbashkon një fill i vetëm. Fati i kryeministrave, që pas një kohe të gjatë e humbasin sensin e së vërtetës, zhyten në një botë virtuale të pompuar nga oborrtarët e nënshtruar dhe sahanlëpirësit që u sillen vërdallë dhe fillojnë të besojnë se realitetin e prodhojnë vetë.

Ato dëshmojnë gjithashtu se vjen një moment kur verbëria e pushtetit të bën që mos e kapësh më kohën që ecën përpara.

Fatos Nano besoi me naivitet, deri në fund, se një video e regjis-

truar në Greqi mund të mos mbërrinte asnjëherë në Shqipëri.

Sali Berisha edhe më keq, shpresoi me budallallëk se ai mund të manipulonte një krim aq të dukshëm, ndërkohë që ai ishte kryer përpara qindra kamerave.

Me këto shembuj ata treguan se ishin të sfazuar me periudhën që jetonin dhe kjo shënoi edhe fundet simbolike të pushteteve që mbartnin.

E njëjta gjë po i ndodh edhe Edi Ramës. Megjithëse hiqet si

një mjeshtër i rrjeteve sociale dhe i komunikimit virtual, ai demonstroi një symbylltasi të pashembullt, duke dashur të shesë si protestues bythëlëpirësit e vet të paskrupull, që u demaskuan sa hap e mbyll sytë në "Facebook", "Instagram", tek "Lolita" dhe dhjetëra faqe të tjera online.

Askush, ende as sot nuk mund ta rrokë, se si ai mendoi se mund t'ia hidhte me një marrëzi të tillë, aq fëmijërore. Askush nuk mund ta imagjinojë se ç'që kur verbëri që i shty sejmënët e tij të mos e shikonin mbretin lakuriq.

Racionalisht ato janë të pa shpjegueshme. Po me sa duket, ashtu sikurse ndodh me të gjitha pushtetet abuzive edhe këtyrë të radhës i ka ardhur ora e gafës së pashpjegueshme. E asaj pikës që derdh gotën. Koha e gabimit fatal.

Në rastin e Edi Ramës, kjo ishte ngjarja që dëshmoi fundin e propagandës. Dhe kur kjo i ndodh një qeverisjeje që atë e ka si të vetmen armë mbijetese, kuptohet lehtë se ç'do të ndodhë më pas. Gjithçka tjetër është thjesht çështje date.

## HOROSKOPI

### DASHI

Sot mund të takoni një mik i vjetër me të cilin mund të ndani kujtime të bukura. Edhe surprizat nuk do të mungojnë gjatë këtij takimi.

### DEMI

Kjo nuk është dita e përshtatshme për të vazhduar përpara me projektet tuaja. Disa pengesa të shkaktuar në mënyrë artificiale do të jenë të pakalueshme.

### BINJAKET

Mos lejoni që situata financiare të bëhet pengesë për realizimin e qëllimeve tuaja. Ku ka vullnet, ka edhe zgjidhje të suksesshme.

### GAFORJA

Sot situata në vendin e punës do të jetë mjaft pozitive. Do të arrini të nxirri në pah anën tuaj me të mirë falë aftësive që keni në disa fusha të ndryshme.

### LUANI

Ditët e fundit mund të jeni ndjerë të lënë pas dore, por kjo jo për fajin tuaj. E tilla ka qenë vendosja e planetëve. Shumë shpejt do të jeni sërish në qendër të vëmendjes.

### VIRGJERESHA

Kjo e sotmja parashikohet të jetë një ditë me të papritura në fushën e ndjenjave. Mund të takoni një person, i cili ka potencialin për të ndryshuar jetën tuaj.

### PESHORJA

Parashikohet të jetë një ditë e ngarkuar me aktivitete. Nëse nuk e merrni me seriozitet, mund të mos arrini suksesin që kaq shumë e keni dëshiruar.

### AKREPI

Përpiquni t'i kanalizoni të gjitha energjitë tuaja drejt qëllimit që i keni vënë vesh në punë. Pa shumë përpjekje, rruga nuk ka për të qenë e lehtë.

### SHIGJETARI

Mundohuni të gjeni paqe me veten. Mendoni pozitivisht dhe gjithçka do të jetë në favorin tuaj. Në dashuri keni nevojë për më shumë variacion.

### BRICJAPI

Ka ardhur koha që idetë të mendimet tuaja t'i vini në zbatim në mënyrë të suksesshme. Nëse nuk angazhoheni sa duhet, gjatat janë që ato të mos realizohen.

### UJORI

Nuk do të mungojnë angazhimet në vendin e punës, por nuk do të jeni shumë i favorizuar për sukses. Merreni me sportivitet dhe qetësi.

### PESHQIT

Keni nevojë për më shumë ritëm në jetën tuaj, por jo gjithçka ecën sipas planeve. Prisni edhe pak dhe do të shikoni se situata do të kthehet në favorin tuaj.

Në një kampionat me 10 skuadra, përballjet me rivalë të drejtpërdrejtë nuk janë të pakta. Partizani, menjëherë pas një sfide mjaft të fortë kundër Teutës, do të ketë një tjetër kundërshtar me potencial të rëndësishëm, Kukësin. "Demat" po u japin fund përgatitjeve në kuadër të këtij dueli. Ashtu siç ka bërë thujtje në qdo takim të këtij sezoni, trajneri Skënder



### Gega nuk heq dorë nga skema e tij

## Partizani pa Asanin, por do të luhet me të njëjtin modul

Gega e ka grumbulluar skuadrën në Elbasan, ku janë zhvilluar edhe dy seancat e fundit stërvitore. Mungesa e madhe e "demave" është pa diskutim ajo e Jasir Asanit. Mesfushori, i cili në këtë sezon

ka qenë një ndër pikat më të forta, ka plotësuar numrin e kartonëve. Për fatin e mirë të teknikut, të kuqtë kanë në dispozicion një lojtar si Esat Mala, i cili mund të përshtatet në disa pozicione. Në këtë mënyrë,

gjasat janë të shumta që Partizani të zbrësë në fushë me këtë 11-she titullare. Në portë, Alban Hoxha. Mbrojtja do të formohet nga Ibrahim, Atanda, Belica dhe Trashë. Në mesfushë do të jenë Mala

nga e djathta, Telushi e Hila në qendër dhe Mensah nga e majta. Në repartin e avancuar do të vendoset Bardhi, pas krahëve të Hebajt. Skema është e njëjta e përdorur në shumë takime, pra 4-4-1-1, një formulë që deri më tani ka rezultuar e suksesshme, teksa mbetet për t'u parë se si do të paraqiten të kuqtë në takimin e parë pa shërbimet e Jasir Asanit.

Sfida më e rëndësishme e javës së 17-të do të luhet në "Selman Stërmasi", luhet për 3 pikë



Jeton Selimi

# Hallaçi: Nuk futemi për barazim ndaj Partizanit

Zv.trajneri i Kukësit, nostalgjik për të shkuarën e kuqe

Partizani dhe Kukësi do të zhvillojnë një takim të rëndësishme ditën e sotme në orën 18:00. Në konferencën e zakonshme për shtyp përpara takimit është paraqitur Rrahman Hallaçi, zëvendës-trajner i ekipit verilindor, që rrefën në konferencën e posaçme për shtyp atë se çfarë është për të kjo përballje, duke qenë se Hallaçi është aktivizuar për 6 sezone me fanellën e kuqe. Por, duke lënë mënjanë nostalgjitë, Hallaçi deklaroi se Kukësi futet në këtë sfidë vetëm për tri pikë. **Ndeshja me Partizanin a vlen titullin?**

Nuk mund të themi se është ndeshja e titullit, por është një ndeshje vendimtare, edhe pse ka ende shumë takime për t'u luajtur. Jemi në një moment të mirë, pasi vijmë pas një fitoreje me një kundërshtar direkt dhe me mjaft të fortë si Skënderbeu. Kemi bërë ndeshje shumë të mira. Kemi arritur të dalim aty ku duhet si me lojë, ashtu edhe me rezultat. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm ndaj Partizanit, pasi nuk duam që të krijojmë distancë me pikë. Kemi shumë mundësi për ta ngulur këtë diferencë. Kam luajtur shumë kohë më parë me Partizanin. E kemi studiuar kundërshtarin dhe e dimë se janë shumë të kujdesshëm. Edhe pse mund të dalin jo shumë herë para porte, arrijnë të shënojnë dhe më pas është shumë e vështirë t'u shënosh



gol. I dimë ato pak pika të dobëta që ata kanë. Ju mungon një lojtar kryesor, por kjo nuk do të thotë asgjë për ta, sepse ata janë përgatitur për të ecur përpara ashtu siç jemi përgatitur edhe ne, pasi kanë shumë lojtarë në organikë. **Nëse vjen një humbje e mundshme...** Nuk e mendojmë që do të humbim ndeshjen, por thashë që

nuk duam që të krijojmë shkakëputjen. Them se është momenti më i mirë, pasi tani duhet të tregojmë veten, tani që e kemi më pranë me pikë. Do ia lëmë rrugës se kush do të arrijë në finishin e pari. **A keni presion?** Nuk mendoj se ka presion Kukësi apo Partizani. Është një ndeshje mes dy skuadrave, që kanë vite që investojnë pa

fund për të shkuar te titulli kampion. Partizani ka shumë vite dhe ka besimin e madh se do të shkojë te titulli, por edhe ne duam me patjetër titullin. Kjo nuk do të thotë se kemi presion. Është ndeshja e radhës, që duhet vlerësuar dhe kaq. **Si është gjendja në skuadër?** Kemi pasur dëmtime, por pjesa kryesore është rikthyer. Vi-

SUPERLIGA		
<b>TE PREMTEN</b>		
Partizani - Kukësi	18:00	
<b>TE SHTUNEN</b>		
Laçi - Tirana	14:00	
Flamurtari - Kamza	17:00	
<b>TE DIELEN</b>		
Kastrioti - Teuta	14:00	
Skënderbeu - Luftëtari	17:00	
<b>RENDITJA</b>		
Skuadra	N	P
Partizani	16	35
Skënderbeu	16	30
Kukësi	16	30
Teuta	16	29
Laçi	16	26
Flamurtari	16	25
Tirana	16	14
Luftëtari	16	13
Kamza	16	12
Kastrioti	16	10

se kemi probleme. Në ndeshjen e parë krijuam shumë raste, ndërsa Partizani u tregua cinik, arriti të shënonte dhe u bë e vështirë për ne që të shënonim më pas. Nuk do ta bëjmë më atë ndeshje, do të kemi më të kujdesshëm dhe do të tregohemi më të vëmendshëm dhe kur të dalim para porte të shënojmë. Në ndeshjen e parë dolëm 7-8 herë para porte dhe nuk shënuam. I kemi menduar mirë këto gjëra. Partizani do ta ketë shumë të vështirë këtë radhë me ne. Kanë pikat e tyre kryesore nga krahët, u mungon lojtari kryesor, por kanë lojtarë të tjerë. **Do të jetë një ndeshje pa tifozë?** Ne do kishim dëshirë të ishin tifozët e Partizanit dhe tonët. Edhe nëse do ishin më shumë tifozë të Partizanit, nuk do ishte problem, pasi lojtarët duan që të kenë sa më shumë tifozë. Problemi është të jetë i mbushur, pasi do të jetë një ambient në gjumë. I kemi marrë masat edhe për këto gjëra, u shpreh Hallaçi.

jon që të jetë në fazë rikuperimi Tigruxha, i cili do të mungojë dhe për këtë takim. Kemi Dzarjan me kartonë, por kemi të tjerët të gatshëm për të luajtur dhe nuk them

Bepe Marota është tash më zyrtarisht pjesë e ekipit të Interit. Ai është prezantuar si administrator i deleguar i klubit zikaltër nga Milano. Marota ka hedhur firmën me klubin e Seria A dhe është mëse i gatshëm që të nisë një aventurë të re dhe emocionuese përsëri në kampionatin italian. Ai ka folur sot para mediave, duke e quajtur veten krenar dhe tashmë pjesë e stafit të ekipit. Ai e ka konsideruar një lëvizje tepër të madhe në aspektin personal, kalimin e tij tek Interi. "Nga sot, bëj pjesë në Interin e madh. Ky është një mo-

### Prezantohet drejtori i ri zikaltër

## Bepe Marota: Krenar që jam pjesë e Interit të madh



ment krenarie të madhe për mua, që do të mbaj postin e administratorit të deleguar. Është një eksperiencë shumë e rëndësishme për jetën time profesionale, e mbushur plot me përgjegjësi. Kjo nuk më tremb, pasi po fillon një rrugë e re dhe shpresoj të jetë fituese", ka përfunduar i emocionuar Marota. **Gjykata rrëzon Juven, titulli i vitit 2006 mbetet i Interit**


Ka rënë poshtë ankimi i Juventusit në lidhje me titullin kampion të vitit 2006, që Federata Italiane ia dha Interit, pas skandalit të Kalçopolit. Kasacioni ka lënë në fuqi vendimin e marrë 12 vite më parë. Gjykata e Apelit të Romës kishte pranuar ankesën e Juventusit, që pretendonte për defekte juridike nga gjykatësit e shtetit. Por Kasacioni ka konfirmuar po atë vendim të dhënë më parë dhe Juventusit ka marrë tashmë edhe "JO"-në e fundit për titullin e shumëpërfolur, që mbetet i Interit.

### TRAJNERI ARGJENTINAS

## Murinjo me valixhe në dorë, Mançesteri do Poketinon

Edheherë me valixhe në dorë, Mançesteri do të largohet nga Angli për të shpëtuar nga tifoza e Manchesterit Junajtidi nuk janë të kënaqur me atë çfarë portugezi ka dhënë në krye të ekipit anglez. Murinjo duhet me patjetër që të renditet në "Top 4" në kampionat, edhe kjo mund të jetë "komerdarja e shpëtimit" për trajnerin e Junajtidi. Por, pavarësisht kësaj, drejtuesit e Mançesterit e kanë një "kartë" rezervë, trajnerin e Tottenham, Mauricio Pochettino. Për argjentinasiin interesohet edhe Reali i Madridit. Sipas "The Mirror", lufta do të jetë e ashpër midis "Dajve të Kuq" dhe "Los Blancos", duke marrë parasysh se klubet mund t'i ndryshojnë stafet teknike në fund të këtij sezoni.

# Fjalëkryqi (1)



### HORIZONTAL

- 1. Immanuel filozof.
- 4. Parashitesë për këteq.
- 8. Argento aktore.
- 11. Gjysmë erotik.
- 13. Janë merrce pa kufij.
- 15. Rastet pa set.
- 16. Në mes të dhomës.
- 18. Rrapo pa çifte.
- 19. Gardner aktore.
- 20. Charlie Mingus.
- 21. Janë pjesë të antenës.
- 23. Eshhtë e tregut në kapitalizëm.
- 24. Eshhtë lojtari underi 21.
- 26. Janë njëvendëshe në Formula 1.
- 28. Qarkullon vetëm në shqipëri.
- 30. Ishin komandantët si Çerçiz Topulli.
- 32. Kishte 100 porta.
- 35. Në krye të aktorëve.
- 36. Gjysma e sltitës.
- 38. Inicialet e Reitman.

- 39. Nganjëherë nuk e vlem qiranë.
- 43. Një ishull si Bikini.
- 44. Nisin nga kreu.
- 45. Një satelit i Uranit.
- 46. Janë kapo.
- 48. Shahu i fundit.
- 49. Janë klasike me tutu.
- 51. U printe hunëve.
- 52. Në fund djathtas.
- 53. Instrumenti i Ravi Shankar.

### VERTIKAL

- 1. Një së larti bëhet me stilin fosbury.
- 2. Kaçaturian kompozitor.
- 3. Kush nuk di mbytetë.
- 5. Inicialet e Harris aktor.
- 6. Një tabu islamike.
- 7. Ka satelit Ariel
- 8. Dy asa.
- 9. Kështu janë mbrojtitet e palëvizshme.
- 10. Mund të skadojë.
- 12. Eshhtë edhe ajo zanore.
- 14. Ishte futbolli i Hollandës.
- 17. Ishin bakantet.
- 21. Janë garat me gregarë.
- 22. Një njëvjeçar.
- 23. Tekat pa kufij.
- 25. Një ekip i Kazanit.
- 27. Fillojnë aksionin.
- 29. Eshhtë hidrokarbur.
- 31. Gruaja e Ben Hur.
- 33. Skuadër greke.
- 34. Barack në shtëpinë e bardhë.
- 37. Capirossi i MotoGP.
- 40. Nuk i tregohën babait.
- 41. Mund të jete fetar.
- 42. Jessica aktore.
- 43. Marsi i akejve.
- 46. Tri të parat në klasifikim.
- 47. Gjysmë tatimi.
- 50. Mbyllin fushata.


# Fjalëkryqi (2)

### HORIZONTAL


- 1. Eshhtë hokotari.
- 8. Loja me full.
- 13. Kaas këngëtare.
- 14. Përdoret kundër malaries
- 15. Këndohet në opera.
- 16. Pak formalitete.
- 17. Eshhtë legjenda.
- 18. Të fundit konak.
- 19. I mbjellë... katastrofa.
- 24. I bëjnë të luajturit.
- 25. Fillojnë mpirjen.
- 27. Janë trupa qiellorë.
- 28. Qendër në kaos.
- 29. Preferojnë yjet e hënën.
- 30. Tri të parat në atletikë.
- 31. Beton pa kufij.
- 32. Ente Autonome Tiranë.
- 33. Një metër në kufij.
- 34. Një stacion... anijesh.

### VERTIKAL


- 1. Catherine aktore.
- 2. Një vijë e lakuar.
- 3. Tatum pa kufij.
- 4. Lidhet në... fyt.
- 5. Inicialet e Camus.
- 6. Në kokë të xixëllonjës.
- 7. Fillojnë hapur.
- 8. Kishin flumur të zi.
- 9. Ndezur në aparaturë
- 10. U shkrua nga Kipling.
- 11. Janë mistere për t'u zgjidhur.
- 12. Rastet pa set.
- 14. Ai ekzekutiv tani është bashki.
- 16. Eshhtë e dukumi në palestër.
- 20. Grandi aktore.
- 21. Eshhtë gjarpër.
- 22. Një pëlluhur sintetikë.
- 23. I bëjnë testet me një set.
- 24. Një monument... për kujtim.
- 26. Atdheu i Papa Eojtjila-s.
- 27. Mund të jenë me katër kohë.
- 29. Një ushtarak me... numër.
- 30. Emri i Salacrou.
- 35. Telefoni në kartvizitë.
- 37. Numri i okteitit.
- 38. Kukulla e Ibsen.
- 40. Thyhet me dy kafshata.
- 44. Rajone Autonome Lokale.
- 46. Ekstreme në eskreme.
- 48. Mbyllin një manastir.




## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

## SUDOKU

3				6				7
		8		1	2	3		
2								9
7		1		3			8	
5			7					1 3
		4			2			
		8		2 9			7 5	
				5				6
1			8		4			

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	5	8	4	6	9	2	7	1
7	2	4	1	3	5	8	9	6
1	6	9	2	7	8	5	3	4
9	3	5	6	4	1	7	8	2
8	1	6	7	9	2	4	5	3
2	4	7	5	8	3	1	6	9
4	7	2	9	5	6	3	1	8
5	9	3	8	1	4	6	2	7
6	8	1	3	2	7	9	4	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

-Sa më filozof është një person, aq më e vështirë të gjejë përgjigje për pyetjet idiote të njerëzve të trashë.

-Eshhtë i mençur ai që vetëm në një rast nervozohet, kur i vjedhin kohën e tij.


-Mendimi i parë është i drejtë! Ndoshta mendimi i fundit është më i saktë por mos humbiseni gjithë kohën duke menduar.

-Jeta është një urë, sa më pak gjëra mbartni, aq më lehtë e kaloni.

## KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



## Thënie të mençura

- Gjithkush që ka bërë një akt të mirë për ne ose na ka thënë një fjalë inkurajimi ka ndihmuar në formimin e karakterit tonë dhe mendimet tona si dhe suksesin tonë.
- Kufizimet jetojnë në mendjet tona. Nëse ju provoni fantazinë, mundësitë nuk kanë kufij.
- "Njohuria banon në kokat e mbushura nga mendimet e njerëzve të tjerë. Mençuria, në një mendje që kujdeset vetëm për mendimet e saj.
- Eshhtë më e lehtë të luftosh për parimet tuaja se sa të jetosh sipas tyre.

